




BEDER JOURNAL OF HUMANITIES

ISSUE: 8 WINTER 2017



About the Journal

Beder Journal of Humanities (BJH) is a peer-reviewed journal published by University Collage Beder, Faculty of Humanities. The main objective of BJH is to provide international scholars an intellectual platform for the exchange of contemporary research. The journal publishes research papers in the fields of Humanities such as Law, Theology, Communications, Spirituality, Economy and Religion, Morality, History, International Relations, Political Science, Public Relation, Marketing, Human Rights and Sociology, Education and Literature. From 2013, Beder Journal of Humanities (BJH) became a scholarly blind peer-reviewed publication, with an Editorial Board and International Advisory Board comprised of eminent scholars in Balkan, Europe and beyond.

EDITORIAL TEAM:

1. - EDITOR-IN-CHIEF

Assoc. Prof. Dr. Rahim Ombashi, University Collage Beder, Albania.

2. - ASSISTANT EDITOR

PhD. Cand. Hysni Skura, University Collage Beder, Albania.

3. - DEPUTY EDITORS

- Dr. Ramadan Çipuri, University Collage Beder, Albania.

- PhD. Cand. Genti Skara, University Collage Beder, Albania

-Msc. Veton Tulla, University Collage Beder, Albania.

-Msc. Hekuran Uzun, University Collage Beder, Albania.

25. PhD. Cand, Adil Kutlu, University Collage Beder, Albania.

26. PhD. Cand, Skënder Bruçaj, Albanian Muslim Community, Albania.

27. PhD. Cand, Ada Güven, University Collage Beder, Albania.

28. PhD. Cand, Elton Karaj, University Collage Beder, Albania.

29. PhD. Cand, Emirjon Senja, University Collage Beder, Albania.

Editorial Board

1. Prof. Dr. Ferdinand Gjana, University Collage Beder, Albania.
2. Prof. Dr. Ayhan Tekineş, University Collage Beder, Albania.
3. Prof. Dr. Njazi Kazazi, "Luigi Gurakuqi" University, Shkodër.
4. Prof. Dr. Remzi Altin, Epoka University, Albania.
5. Prof. Dr. Shezai Rrokaj, Tirana University, Albania.
6. Prof. Dr. Valentina Duka, Tirana University, Albania.
7. Prof. Dr. Hajri Shehu, Tirana University, Albania.
8. Prof. Dr. Kseanela Sotirofski, "Aleksandër Moisiu" University, Albania.
9. Prof. Dr. Rami Memushaj, Tirana University, Albania.
10. Assoc. Prof. Dr. Gentiana Skura, Tirana University.
11. Assoc. Prof. Dr. Bünyamin Çağlayan,
12. Assoc. Prof. Dr. Agron Tufa, Tirana University, Albania.
13. Assoc. Prof. Dr. Mark Marku, Tirana University, Albania.
14. Assoc. Prof. Dr. Bashkim Gjergji, Tirana University.
15. Assoc. Prof. Dr. Genciana Abazi Egro, Tirana University.
16. Dr. Isa Erbaş, University Collage Beder, Albania.
17. Dr. Genti Kruja, University Collage Beder, Albania.
18. Dr. Edlira Mali, University Collage Beder, Albania.
19. Dr. Fatih Ufuk Bağcı, University Collage Beder, Albania.
20. Dr. Erlis Çela, University Collage Beder, Albania.
21. Dr. Belfiore Qose, MAS, Albania.
22. Dr. Irvin Faniko, University Collage Beder, Albania.
23. Dr. Nertil Bërdufi, University Collage Beder.
24. Dr. Brikena Smajli, University Collage Beder.

International Advisory Board

1. Prof. Dr. İsmail Albayrak, Australian Catholic University,
2. Prof. Dr. John Esposito, Georgetown University, Washington,
3. Akad. Feti Mehdiu, Pristina, Kosovo.
4. Prof. Dr. Hans Köchler, Innsbruck University, Austria.
5. Prof. Dr. Jon Pahl, Lutheran Theological Seminary, USA.
6. Prof. Dr. Muhit Mert, Fatih University, Istanbul, Turkey
7. Prof. Dr. Mark Webb, Texas Tech. University, USA.
8. Prof. Dr. Mehmet Rihtim, Kafkas University, Azerbaijan.
9. Prof. Dr. Paul Weller, University of Derby, U.K.
10. Prof. Dr. Admiel Kosman, Potsdam University, Germany.
11. Prof. Dr. Briseida Mema, "Hëna e Plotë" (Beder) HEI, Albania.
12. Prof. Dr. Sebastiano Tafaro, Bari University, Italy
13. Prof. Dr. Ardian Nuni, Tirana University, Albania.
14. Assoc. Prof. Dr. Zeki Sarıtoprak, John Carrol University, USA.
15. Prof. Dr. Cafer Sadık Yaran, Ondokuz Mayıs University, Turkey.
16. Prof. Dr. Francesco Zannini, Pontificio Istituto di Studi Arabi e d'Islamistica, Italy.
17. Prof. Dr. Altin Shegani, Tirana University, Albania.
18. Assoc. Prof. Dr. Ahmet Ecirli, Institute of Sociology, Academia Romana
19. Prof. Dr. Ferit Duka, UET, Albania.
20. Prof. Dr. Qazim Qazimi, University of Pristina, Kosovo.
21. Prof. Dr. Kerima Filan, Sarajevo University, Bosnia
22. Prof. Dr. Recep Ileri, Universitate Europeli de Sud-Est
23. Lumina, Romania.
24. Prof. Dr. Cihan Okuyucu, Suleyman Sah University, Turkey.
25. Prof. Dr. Abudllah Hamiti, University of Pristina, Kosovo.
26. Prof. Dr. Hamit Xhaferri, Universiteti UEJ, Tetovo, Macedonia.

Beder HEI Faculty of Humanities



BEDER JOURNAL OF HUMANITIES

ISSUE: 8 WINTER 2017

Publication Frequency: Biannual

ISSN: 2306-6083

Tirana, Albania

www.bjh.beder.edu.al

TABLE OF CONTENTS

Dr. Genti Kruja, KU Bedër

Prof. Asoc. Dr. Gentiana Skura, Universiteti i Tiranës

Dr. Robert Gjedia, Universiteti “Marin Barleti

Të mësuarit e normave civile në medresetë e Shqipërisë 5

Dr. Ferdinand Xhaferaj

Democratic Control of Military: The Role of Legislatures 36

Dr. Atakan Derelioglu, KU Bedër

Pluralizmi fetar në burimet parësore të Islamit 68

Dr. Adil Kutlu, KU Bedër

Disa qasje sociologjike mbi dukurinë Fe 85

MA. Gjenis Haxhimehmeti

Aspekte ligjore të bashkëpunimit ndërmjet shteteve të Unionit Evropian për menaxhimin e refugjatëve 103

PhD. Cand. Hysni Skura, KU Bedër

Dashuria Hyjnore në këndvështrimin Islam 122

**Dr. Genti Kruja, KU “Bedër” Prof. Asoc. Dr. Gentiana Skura,
Universiteti i Tiranës Dr. Robert Gjedia, Universiteti “Marin
Barleti”**

gkruja@beder.edu.al

Të mësuarit e normave civile në medresetë e Shqipërisë

Hyrje¹

Medresetë në Shqipëri kanë një traditë shekullore. Ato u themeluan shumë shpejt pas pranimit të Islamit nga shqiptarët që në shek. XV-XVI, vazhduan funksionin e tyre edhe pas shpalljes së pavarësisë, por të përballura me vështirësi ekonomike, didaktike dhe arsimore, pa një kontroll qendror. Ato nuk kishin një plan-program, por vazhdonin të jepnin mësimdhënie me plan-programin e shumë viteve më parë.² Sipas informacioneve, që kalojnë në revistën e parë zyrtare të Komunitetit Mysliman Shqiptar *Zani i Naltë*, në muajin prill 1927, gjendeshin 12 medrese në qytetet: Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Kavajë, Durrës, Tiranë, Krujë, Shijak, Peqin, Elbasan, Korçë dhe Berat, të cilat vazhdonin funksionin e tyre.³ Krahas këtyre kishte edhe shumë mejtepe (mektebe), pranë xhamive, që drejtoheshin kryesisht nga imamët e xhamive.

¹. Ky studim është kryer në bazë të projektit “Të mësuarit e normave civile në shkollat e Fesë Islame - medresetë”, nga Forumi Shqiptar për Aleancën e Qytetërimeve, Tiranë, 2017.

². Basha, Ali M., “Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)”, Tiranë 2011: 174.

³. Vuçiterni, Salih, “Nji pergjigje Z. Hafis Xhaferit”, Kolana “Zani i Naltë: Vëllimi i Dytë, vitet 1926-1927-1928, botues: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, 2015:274-275.

Për shkak të mendimit se medresetë, që ekzistonin nuk u përgjigjeshin nevojave të kohës, u pa e arsyeshme hapja e medreseve me një stil të ri. Kështu Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve iu propozua nga Këshilli i Naltë i Sheriatit formimi i një medreseje të re në Tiranë dhe më 2 qershor të vitit 1923, në Kongresin e Parë të Myslimanëve Shqiptarë, u mor vendimi për formimin e Medresesë së Naltë në Tiranë.⁴ Në numrin e tretë të revistës *Zani i Naltë* të vitit 1923, në nenin 9 të rregullores së medresesë përcaktohej se medreseja do të përbëhej nga tre kategoritë vijuese: “Kategoria fillestare e medreses asht 3 vjet, mesatarja 5, dhe e alta 4 vjet”.⁵ Pra Medreseja do të ishte edhe si një shkollë e lartë, por për arsye financiare nuk u arrit që ajo të ishte një Institut i Lartë, duke qenë ndoshta edhe i pari universitet në trojet shqiptare. Megjithatë, mbetet për t’u vlerësuar iniciativa, guximi dhe largpamësia intelektuale e drejtuesve të Komunitetit Mysliman Shqiptar të atyre viteve me në krye dijetarë të tillë si Haxhi Vehbi Dibra e Hafiz Ali Korça.

Vendimi për hapjen e Medresesë së Tiranës u pranua edhe nga ana e qeverisë Shqiptare të asaj kohe. Medreseja e Tiranës e filloi aktivitetin e saj nën emrin *Medreseja e Naltë*. Sipas vendimit të marrë në Kongresin e III-të të Myslimanëve Shqiptarë të mbajtur në vitin 1929, u mbyllën të gjitha medresetë e tjera, me përjashtim të medresesë së Tiranës. Për shkak këtij vendimi, emri i medresesë së kryeqytetit u ndryshua, duke u emërtuar si *Medreseja e*

⁴. Basha, 2011: 93.

⁵. Kruja, Genti, (editor), “Rregullore mbi Medresen e Myslimanve”, *Zani i Naltë*, vëllimi i parë, vitet 1923-1924/-1925, botues: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, Tiranë, 2014: 87.

Përgjithshme.⁶ Sipas nenit 57 të statutit të Kongresit të III-të Medreseja e Përgjithshme përfshin vetëm 2 kategori, atë të unikes dhe të mesmes.⁷

Ndërtesa e bërë për Medresenë e Tiranës përfundoi në vitin 1931. Ajo brenda disa vitesh u bë një institucion serioz, që ndihmoi në formimin e identitetit kombëtar dhe fetar të nxënësit. Medreseja, qysh nga fillimi i edukimit, zbatoi një program bashkëkohor. Në programin, që ndiqte medreseja iu dha përparësi disa lëndëve që lidheshin me kulturën e përgjithshme, si gjuha dhe letërsia, ashtu siç ndodhte edhe në shkollat shtetërore⁸.

Cilësia e mësimdhënies në medrese nuk lidhej vetëm me një shkak, apo me disa lëndë, por lidhej me të gjitha lëndët, që gjendeshin në program dhe kjo gjendje sillte si rezultat rritjen e nivelit shkencor dhe atij kulturor-fetar të nxënësve. Feja islame në të njëjtën kohë zbret në problemet e edukimit dhe kështu ka dhënë ndihmën e saj në formimin e nxënësve, të cilët bashkë me moralin islam marrin edhe moralin e të qenët një bashkëqytetar i mirë.⁹

Menjëherë pas instalimit të komunizmit në Shqipëri në vitin 1944, filloi edhe presioni e persekutimi ndaj prijësve fetarë, duke u arrestuar e burgosur shumë hoxhallarë dhe mësues të medresesë së Tiranës. Duke vazhduar procesin e edukimit nën kushte të vështira, në vitin 1964 medreseja u mbyll përfundimisht¹⁰. Ndërkohë, në vitin 1967, u ndaluan të gjitha besimet fetare me ligj dhe u mbyllën komunitetet fetare dhe veprimtaritë e tyre. U shkatërruan mbi 1.000 xhami, kisha, teqe dhe varreza. U sekuestruan bibliotekat e të gjithë

⁶. Basha, 2011: 93.

⁷. Po aty, 215.

⁸. Basha, 2011: 99.

⁹. Balla, Xhemal, "Haxhi H. Mahmut Dashi, jeta dhe vepra 1873-1961", Tiranë: West Print. 2010: 60-61.

¹⁰. Po aty, 2011: 539.

klerikët, ku shumica e librave u dogjën dhe asgjësuan. Kjo frymë ateiste, vazhdoi deri në vitin 1990.

Komuniteti Mysliman, i cili qe mbyllur në vitin 1967, u riinstitucionalizua edhe njëherë për të vijuar veprimtarinë e tij në vitin 1991.¹¹

Me riinstitucionalizimin e Komunitetit Mysliman në vitin 1991 u hap sërish Medreseja e Tiranës, e cila u ndoq prej hapjes së Medresesë së Shkodrës. Ndërsa, në vitet pasardhëse u hapën medrese në Durrës, Kavajë, Korçë dhe Elbasan (ndërsa medresetë e hapura në Gjirokastrë, Kukës, Berat dhe Peshkopi janë mbyllur pas disa vitesh funksionimi).

1. Statuset zyrtare të medreseve në Shqipëri

Sipas pikës së parë të nenit 7 të ligjit “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, thuhet: “Arsimi parauniversitar është laik”, dhe ndërsa shprehet kështu, në pikën e dytë të të njëjtit nen, shkruhet: “Përfashtim bëjnë ato institucione arsimore, që themelohen nga bashkësi fetare të njohura me ligj, sipas përcaktimeve të nenit 42 pika 4 të këtij ligji” (Ligji nr. 69/2012, neni 7/1, 7/2).

Po në të njëjtin ligj, në pikën e katërt të nenit 42, shprehet: “Institucionet arsimore private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare, ose që themelohen, apo administrohen nga bashkësitë fetare, hapen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, mbështetur në kërkesën e përfaqësuesve të bashkësive fetare. Kriteret dhe procedurat e hapjes

¹¹. Zaimi, Ali & Kruja, Genti (editorë), “Katalog i Veprimtarisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, botimet KMSH, Tiranë, 2014:9.

së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave” (Ligji nr. 69/2012, neni 42/4).

Sipas burimeve arkivore të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH), lejimi i hapjes së medreseve me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe me statusin e shkollave jopublike, ka nisur në vitin 1995. Në vendimin nr. 654, të datës 29.11.1995, shprehet se u është dhënë leje e përkohshme për kryerjen e veprimtarisë; Medresetë zhvillojnë kurrikulën zyrtare për ciklet e arsimit parauniversitar, por gjithashtu kanë dhe pjesën e kurrikulës me orientim fetar, e cila edhe kjo miratohet nga Ministria e Arsimit.

Lëndët fetare janë integruar në kurrikulat zyrtare të medreseve në mënyrë të tillë që të jenë mbështetëse edhe të tematikave të trajtuara nga lëndët e edukatës qytetare. Meqenëse njeriu që jeton në sistemin demokratik ka shumë përputhje me besimtarin (pavarësisht përkatësisë fetare), tematikat e përbashkëta të këtyre lëndëve janë të shumta.

Lëndët fetare që zhvillohen në medresetë e ciklit 9-vjeçar dhe atij të mesëm të lartë janë “Kur’ani Famëlartë - Komentimi i tij”, “Tradita profetike dhe Kultura Islame”, “Njohuri Besimi e Kulture Islame”, “Njohuri të Traditës Profetike e Predikim”, “Njohuri të Adhurimit Islam”, “Modul Profesional: Civilizim Islam”, “Njohuri të Traditës Profetike dhe të Predikimit”, “Besimi”, “Edukatë Islame”.

Ndërsa, sipas vendimit nr. 560, i datës 26.8.1996, të Këshillit të Ministrave, u jepet leja (liçenca) për kryerjen e veprimtarive mësimore medresesë “Mahmud Dashi” në Tiranë, medresesë “Hafiz Ali Korça” në Kavajë, medresesë “Liria” në Cërrik, medresesë “Hoxha Tahsin” në

Gjirokastrër dhe medresesë “H. Sheh Shamija” në Shkodër.¹² Pesë medreseve të tjera, asaj “Mustafa Varoshi” në Durrës, medresesë “Vexhi Buharaja” në Berat, medresesë “Sulejman Laçi” në Kukës, medresesë “Raif Kadiu” në Peshkopi dhe medresesë së Korçës, u kërkohet që të mos marrin nxënës të rinj, por u lejohet kryerja e veprimtarive arsimore gjer në maturimin (diplomimin) e nxënësve të marrë para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7952, të datës 21.6.1995.¹³

Megjithëse medresetë kryejnë veprimtarinë e tyre arsimore prej vitit 1991, dhënia e lejeve, të përkohshme, apo të vazhdueshme në periudhën 1995-1996, tregon se ato i kanë kryer veprimtaritë e tyre bazuar në lejen fillestare, që u është dhënë prej autoriteteve.

Medresesë “Vexhi Buharaja” në Berat i rijepet leja e funksionimit me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 248 datë 28.05.1999. Në të njëjtën mënyrë edhe medresesë “Mustafa Varoshi” në Durrës i rijepet leja e funksionimit me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 653 datë 29.12.1999, ndërsa përsa i përket medresesë “Abdullah Zëmlaku” në Korçë, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 04.12.2002 i jepet licenca për arsimin e mesëm, kurse për kryerjen e veprimtarive arsimore të arsimit 9-vjeçar u është dhënë licenca me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1067, datë 21.10.2009.¹⁴

Sot, medresetë e Gjirokastrës, Kukësit dhe Peshkopisë nuk i vazhdojnë veprimtaritë e tyre. Sipas burimeve të KMSH-së, Medreseja e Gjirokastrës, megjithëse është e licencuar, për shkak të pamundësive financiare, nuk i vijon

¹². Kutlu, Adil, “Perceptimi i prindërve lidhur me edukimin fetar në Shqipëri: rasti i medreseve”, teze doktorature, UET, Tiranë, 2016:169.

¹³. Po aty.

¹⁴. Po aty.

veprimtaritë e saj arsimore qysh prej vitit 2009, kurse medreseja e Kukësit dhe e Peshkopisë, për shkak se nuk janë të licencuara, kanë rreshtur se kryeri veprimtarinë e tyre që në vitin 1996, me përjashtim të nxënësve, që ishin në proces mësimi gjer në diplomimin e tyre. Medreseja e Beratit u shkri në vitin akademik 2016-2017 dhe nxënësit që ishin u transferuan në medresetë tjera. Në fund të vitit shkollor 2015-2016 numri i nxënësve të regjistruar ka qenë gjithsej 64 nxënës, ndërsa për vitin mësimor 2016-2017 kishte 77 nxënës gjithsej.¹⁵

Aktuakisht (2018) janë gjithsej 6 medrese, që vijojnë veprimtaritë e tyre arsimore edukative në qytetet e Tiranës, Shkodrës, Elbasanit, Korçës, Durrësit dhe Kavajës. Sponsorizimi i medreseve të Tiranës, Korçës, Elbasanit dhe Kavajës bëhet nga Fondacioni “Sema”, ndërsa medreseja e Shkodrës bëhet nga Fondacioni “Istanbul” dhe ajo e Durrësit nga Fondacioni “Mirësia”. Përsa i përket strukturës administrative të medreseve, ato administrohen sipas protokolleve të parashikuara prej Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe fondacioneve respektive, ndërkohë që drejtorët e shkollave përzgjidhen nga KMSH, fondacionet mbështetëse kanë të drejtën e emërimit të një koordinatori.

2. Informacione të përgjithshme rreth medreseve

Në vijim, në bazë të burimeve të përfuara prej drejtorive të secilës prej medreseve, do të rrekemi të japim një informacion të përmbledhur në lidhje

¹⁵ Duke qenë se ky studim është kryer duke marrë për bazë vitin akademik 2016-2017, kur Medreseja e Beratit ishte funksionale, është marrë për bazë edhe Medreseja e Beratit gjatë gjithë studimit.

me secilën prej tyre, duke marrë si bazë vitin shkollor 2015-2016 dhe 2016-2017 (aktual).

2.1. *Medreseja “Haxhi Mahmud Dashi”, Tiranë*

Në organigramën e medresesë së Tiranës bëjnë pjesë të gjithë përbërësit e arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm, si për vajza ashtu edhe për djem, që nga klasa e gjashtë. Vetëm se, nxënësit e arsimit të mesëm, djem dhe vajza, strehohen në konvikte të ndryshme, ndërsa nxënësit nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë ndjekin vetëm procesin mësimor gjatë ditës. Numri i nxënësve të regjistruar në fund të vitit arsimor-akademik 2015-2016 ishte 445 nxënës (207 djem, 238 vajza), ndërsa për vitin aktual mësimor 2016-2017 është 416 (178 djem, 238 vajza) nxënës gjithsej.

2.2. *Medreseja “Haxhi Sheh Shamija”, Shkodër*

Edhe medreseja e Shkodrës, po ashtu, përbëhet prej programesh të arsimit 9-vjeçar dhe atij të mesëm. Ndërkohë që shkolla 9-vjeçare nis nga klasa e gjashtë deri në të nëntën, shkolla e mesme përbëhet nga klasa e dhjetë, e njëmbëdhjetë dhe e dymbëdhjetë. Në medresenë e Shkodrës ofrohen kushte të ndara strehimi, si për djemtë ashtu edhe për vajzat. Nxënësit nga klasa e gjashtë deri në të nëntën ndjekin vetëm procesin mësimor gjatë ditës. Numri i nxënësve të regjistruar për vitin aktual mësimor 2016-2017 është 1068 (425 djem, 643 vajza) nxënës gjithsej.

2.3 *Medreseja “Liria”, Elbasan*

Medreseja “Liria” në Elbasan është një shkollë e mesme, ku studiojnë vetëm nxënës djem. Medreseja “Liria” në Elbasan, nga viti 1995 kur ka nisur aktivitetin e saj, deri në vitin 2012-2013, ka qenë e vendosur në Cërrik, ndërsa prej vitit 2013-2014, ajo i vijon veprimtaritë e saj në qendër të qytetit të Elbasanit. Kjo medrese ofron edhe kushte akomodimi në konvikt për nxënësit, që zgjedhin të vijnë nga rrethet. Në fund të vitit shkollor 2015-2016, ky institucion ka pasur gjithsej 151 nxënës, ndërsa për vitin aktual mësimor 2016-2017 është 144 nxënës gjithsej.

2.4. Medreseja “Hafiz Ali Korça”, Kavajë

Medreseja e Kavajës, e cila e nisi aktivitetin e saj arsimor-edukativ si një shkollë e mesme jopublike vetëm për nxënës djem, prej vitit shkollor 2012-2013 nisi të arsimojë edhe nxënëse vajza, por në një tjetër godinë. Kjo medrese nuk përfshin nxënës të arsimit 9-vjeçar. Ajo ofron kushte strehimi në konvikt më tepër për nxënësit që vijnë nga jashtë Kavajës, si për djem ashtu edhe për vajza. Numri i nxënësve të regjistruar në fund të vitit arsimor-akademik 2015-2016 ishte 253 nxënës (116 djem, 137 vajza), ndërsa për vitin aktual mësimor 2016-2017 është 258 (121 djem, 137 vajza) nxënës gjithsej.

2.5. Medreseja “Hafiz Abdullah Zëmbllaku”, Korçë

Medreseja e Korçës, e cila qe mbyllur për një periudhë kohe, pas vitit 2009 rinisi veprimtarinë e saj si shkollë e mesme jopublike për djem dhe vajza. Edhe ajo ofron kushte të njëjta strehimi në konvikt për djemtë dhe vajzat që vijnë nga rrethet apo edhe nga brenda Korçës. Numri i nxënësve të regjistruar në fund të vitit arsimor-akademik 2015-2016 ishte 273 nxënës (101 djem, 172

vajza), ndërsa për vitin aktual mësimor 2016-2017 është 271 (112 djem, 159 vajza) nxënës gjithsej.

2.6. Medreseja “Haxhi Mustafa Varoshi”, Durrës

Medreseja e Durrësit, që dikur ka pranuar edhe nxënës djem, sot është një shkollë e mesme që u drejtohet vetëm vajzave. Veç kësaj, ndryshe nga medresetë e tjera, ajo gjendet në qendër të qytetit të Durrësit, por nuk ofron kushte akomodimi në konvikt. Në fund të vitit shkollor 2016-2017 në të ka pasur të regjistruar gjithsej 105 nxënës.

Filozofia e medreseve të Shqipërisë sot

Filozofia e medreseve të Shqipërisë, edukimin e ka parë nga tri kënde të gërshetuara mes vete: human-psikologjik, kombëtar-social dhe universal.

Për sistemin arsimor të Komunitetit Mysliman sot, ndarja e të menduarit fetar nga shkencat natyrore shkon kundër frymës së Kur'anit, sepse ai e rekomandon qartë lidhjen e besimit me shkencat natyrore.

Sistemi edukativ i medreseve, hapi rrugën për një epokë të re, duke ribashkuar sistemin edukativ bashkëkohor me sistemin klasik të medreseve të dikurshme. Kështu mund të vërehet se nuk ekziston ndonjë mospërputhje, apo përplasje dialektike ndërmjet shkencave natyrore dhe vlerave, qofshin ato fetare, etike, sociale apo individuale. Medresetë sot bashkojnë mendjen dhe zemrën nëpërmjet përqendrimit në një objektiv, që merr parasysh mënyrën sesi duhen integruar dija dhe edukimi te njerëzit dhe te jeta sociale.

Në sistemin edukativ të këtyre shkollave, një person shihet si pjesëmarrës aktiv në proceset sociale. Shkollat i përkasin një modeli, që

vendos balancën ndërmjet botës materiale dhe shpirtërore, pa e zvogëluar ndonjërin në dëm të tjetrës, në mënyrë që të ndërtojë një model aktiv, i tillë që është në gjendje të mbartë përgjegjësinë e dialogut kulturor dhe shoqëror.

Metodologjia

Qëllimi i studimit: Të identifikojë dhe të analizojë sesi realizohet edukimi qytetar te Medresetë. Ndikimi dhe roli i të mësuarit të normave civile te shkollat fetare – medresetë.

Objektivat e studimit:

1. Shqyrtim i dokumentacionit zyrtar, kurrikular të medreseve, por dhe i kurrikulës shtetërore për formimin qytetar.
2. Tryeza pune të ekipit që menaxhoi, zhvilloi dhe hartoi këtë studim
3. Fokus grupe me drejtuesit e të shtatë medreseve në Shqipëri (shtator-tetor 2016)
4. Pyetësorët për mësuesit e të shtatë medreseve në Shqipëri (shtator-tetor, 2016)
5. Pyetësorët për nxënësit e të shtatë medreseve në Shqipëri (shtator-tetor, 2016)
6. Përpunim statistikor i gjetjeve (nëntor-dhjetor, 2016)
7. Paraqitje e gjetjeve dhe rekomandimeve te grupet e interesit, që janë të interesuar për trajtimin e çështjeve të edukimit qytetar nëpërmjet lëndëve fetare në shkolla 9-vjeçare, shkolla të mesme, specialistë të edukimit në institucionet qeverisëse të arsimit në nivel lokal dhe qendror, por dhe nga fakultetet që përgatisin mësues.

Ky kërkim ka përdorur një nga përqasjet mikse të kërkimit shkencor, paradigmen e triangulimit bashkërendues, e cila lejon kombinimin e njëkohshëm të kërkimit sasior dhe atij cilësor. Të dyja metodologjitë u kombinuan me qëllim adresimin e çështjes kërkimore. Kjo përqasje u përzgjodh për një sërë arsyesish të cilat do prezantohen shkurtimisht më poshtë.

Realizimi i qëllimeve dhe objektivave të kërkimit

Projekti kërkimor synoi të adresonte çështjen kërkimore nga disa aspekte të ndryshme; përfshirë këtu matje të aktorëve: drejtues, stafit akademik, si dhe nxënësve të medreseve. Për këtë arsye u përdorën pyetësorët si mjetet më të mira për mbledhjen e të dhënave kur bëhet fjalë për matjen e perceptimeve mbi normat civile në shkollat fetare.

Mjetet për mbledhjen e të dhënave dhe kampioni

Të dhënat cilësore marrin trajtën e fjalëve (të folura ose të shkruara) dhe imazheve vizive (të vrojtuar ose të krijuara). Kryesisht shoqërohen me strategji studimi, si studim rastit, teori fushe, etnografi dhe fenomenologji, dhe me metodat kërkimore, si intervista, dokumente dhe vëzhgime. Të dhënat cilësore sidoqoftë mund të përftohen edhe ndryshe. Për shembull, përdorimi i pyetjeve me fund të hapur, si pjesë e një pyetësori sondazh, mund të japë përgjigje në formë teksti - fjalë të shkruara që mund të trajtohen si të dhëna cilësore.

Intervistat janë një sugjerim tërheqës për studiuesit e projektit. Në shikim të parë, ato nuk duket se përfshijnë shumë gjëra teknike. Intervistat janë

diçka më shumë sesa thjesht një bashkëbisedim. Intervistat përfshijnë një sërë supozimesh dhe kuptimesh rreth situatës, që normalisht nuk janë të lidhura me një bashkëbisedim të rastësishëm (Descombe 1983; Silverman 1985).

Për të qenë më specifik, intervistat - në veçanti intervistat *në thellësi* - e lënë veten në mbledhjen e të dhënave bazuar në:

- *Opinione, ndjenja, emocione dhe eksperiencia*
- *Çështje të ndjeshme*
- *Informacione të privileguara*

Intervistat gjysmë të strukturuar

Në intervistat gjysmë të strukturuar intervistuesi është i përgatitur që të jetë fleksibël në aspektin e qëllimit të temave të marra në konsideratë dhe që të lejojë të intervistuarin të zhvillojë ide dhe të flasë më gjerësisht rreth çështjes së ngritur nga studiuesi. Përgjigjet janë të hapura (open-ended) dhe ka më shumë theksim në përpunimin e interesit të intervistuesit.

Fokus grupet

Fokus grupi me drejtues u realizua me të gjithë drejtuesit e medreseve, përkatësisht me 10 të tillë. U realizuan 16 pyetje që siguruan të dhëna për moshën, kualifikimin e drejtuesve, por edhe gjetje për kualifikimin e mësuesve, që zhvillojnë edukimin qytetar nëpërmjet lëndëve fetare dhe jofetare, por edhe informacione rreth zhvillimit të lëndëve të qytetarisë në medrese. Në veçanti u mbledhën të dhëna për nxënësit, nga vijnë ata, sa jetojnë në konvikte, si dhe rreth bashkëpunimit shkollë-familje, por edhe të bashkëpunimit me njësitë vendore arsimore (DAR-et), por edhe me Ministrinë

e Arsimit dhe Sportit. Me interes janë të dhënat sasiore sesa nxënës të medreseve vijnë shkollat e larta dhe çfarë degësh studiojnë ata.

Pyetësori për mësuesit u hartua me 9 pyetje. Pyetjet ishin të llojeve të ndryshme dhe mundësonin vjeljen e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë, p.sh. pyetjet me alternativa, por edhe me anë të pyetjeve të hapura, që na mundësonin mbledhjen e ideve, mendimeve dhe gjykimeve, që mësuesit kishin për zhvillimin e lëndëve të formimit qytetar si: “Edukimi për shoqërinë” dhe “Qytetaria” sipas kurrikulës shtetërore, por dhe të 9 lëndëve fetare, që janë pjesë e kurrikulës së medreseve, që ofrojnë edukim qytetar. Përmbajtja e pyetjeve kishte të bënte me procesin e zhvillimit të kurrikulës lidhur me përbërës të saj si: përmbajtja e kurrikulës së edukimit qytetar, kompetencat qytetare, që synohen të krijohen te nxënësit, projektet kurrikulare që zhvillohen dhe tematikat e tyre, veprimtaritë kros dhe ekstrakurrikulare, metodologjitë që zbatohen në klasa dhe jashtë tyre për edukimin qytetar, por edhe identifikimin e pikave të dobëta dhe të forta që janë ndeshur për zhvillimin e kësaj lënde. Të gjithë këto elementë kurrikularë, të paraqitur në pyetësor, prekin kurrikulën e lëndëve fetare dhe atyre jofetare, që synojnë formimin qytetar. Gjithashtu ato mundësojnë edhe identifikimin e tematikave të përbashkëta, që zhvillojnë lëndët fetare dhe jofetare, por edhe të atyre çështjeve, që i trajtojnë veçmas. Pyetësori, nga ana tjetër, shërbeu dhe për të siguruar të dhëna për shkallën e kualifikimit të mësuesve të edukimit qytetar në medrese, moshën e tyre, tregues që kanë rëndësi për zhvillimin e këtij edukimi.

Pyetësori për nxënësit u hartua me 10 pyetje. Pyetjet ishin të llojeve të ndryshme dhe mundësonin mbledhjen e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë, kryesisht me anë të pyetjeve me alternativa, por edhe me anë të një pyetje të hapur, që mundësonte të dhëna për idetë, mendimet dhe gjykimet që nxënësit kishin për edukimin e tyre qytetar nëpërmjet lëndëve fetare dhe jofetare. Po ashtu, pyetësori siguron të dhëna për tematikat e trajtuara në edukimin qytetar, projektet kurrikulare të zhvilluara, por edhe për klimën dhe bashkëpunimin në shkollë, si dhe për mjediset fizike të shkollës dhe sigurinë në to.

Kampionimi dhe popullata e intervistuar

Për pyetësorët e mësuesve janë përfshirë 31 mësues që janë afërsisht 20% e numrit total të mësuesve të medreseve në Shqipëri. Për pyetësorët e nxënësve janë përfshirë 505 nxënës gjithsej, që tejkalojnë më shumë se 20% të numrit total të tyre, por edhe është marrë në konsideratë me përparësi shpërndarja e plotësimit të pyetësorëve nga nxënës të të gjitha klasave në medrese. Numri i drejtuesve të pyetur ishte 10, që përbën 100% të tyre si drejtues të medreseve.

Popullata: Realizimi i këtij punimi u mendua të bëhet me mësues, nxënës dhe drejtues të medreseve.

Kampioni: 505 nxënës, 31 mësues, 10 drejtues nga të gjitha medresetë e vendit.

Dokumentacion dhe instrumente: Në realizimin e studimit në fjalë janë përdorur këto instrumente:

- *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar*
- *Programet lëndore të lëndëve të “Edukimit për shoqërinë” dhe “Qytetaria” në arsimin publik, parauniversitar*
- *Dokumentacioni zyrtar, kurrikular i medreseve për ciklin e mesëm të ulët (klasat 6-9) dhe për ciklin e mesëm të lartë (klasat 10-12).*
- *Programet e lëndëve fetare që ofrojnë edukim qytetar*
- *Literaturë e printuar dhe ajo on-line për edukimin fetar*
- *Pyetësorë*
- *Fokus-grup me pyetje për drejtuesit*

Etika. Ky studim u krye me lejen, mbështetjen dhe bashkëpunimin vullnetar të mësuesve, drejtuesve dhe nxënësve të 7 medreseve, ku një rol mbështetës dha Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (KMSH). Pjesëmarrësit në studim u informuan rreth rëndësisë së të dhënave, si dhe iu garantua privatësia. Rezultatet e studimit janë bërë publike vetëm për qëllimin e studimit.

Pjesa 1. Analizë deskriptive e kurrikulës së formimit qytetar

1.1. Kurrikula e edukatës qytetare në lëndët jofetare

Institucionet arsimore “Medrese” janë shkolla të arsimit bazë dhe atij të mesëm të lartë që zhvillojnë procese të edukimit dhe arsimimit në 6 qytete

të Shqipërisë, përkatësisht në Tiranë, Shkodër, Kavajë, Elbasan, Korçë dhe Durrës.

Kurrikula, që ato zbatojnë, është tërësisht e miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Kjo nënkupton atë që ciklet arsimore të medreseve zbatojnë kurrikulën zyrtare përkatëse, që lidhet me përmbajtjet e paraqitura në dokumentacionin zyrtar, kurrikular si: Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar¹⁶, Kompetencat dhe rezultatet e të nxënit, Programet lëndore¹⁷, Udhëzuesit e ndryshëm për zhvillimin e kurrikulës, si dhe tekstet shkollore.

Ndonëse këto institucione zhvillojnë edhe edukim fetar, kurrikulat e të cilave rast pas rasti miratohen për zbatim në Ministrinë e Arsimit¹⁸, nga ana tjetër medresetë ofrojnë dhe edukim qytetar konform përmbajtjes dhe kërkesave të kurrikulës zyrtare.

Kurrikula e edukimit qytetar, që zhvillohet edhe në ciklet arsimore të medreseve, është pjesë e kurrikulës bazë të arsimit të detyrueshëm dhe e arsimit të mesëm të lartë në Shqipëri. Pas viteve ‘90 të shekullit të kaluar, që kur Shqipëria nisi proceset demokratike e deri në ditët e sotme, politikbërësit e arsimit e konsiderojnë të domosdoshëm formimin e qytetarisë demokratike të brezave të rinj në mënyrë që ata të jenë të aftë të jetojnë dhe të përballojnë sfidat e demokracisë.

Përgjatë periudhës 26 vjeçare (1990-2016) fusha kurrikulare e shkencave shoqërore ka pasur brenda saj lëndë të tilla si: “Edukata shoqërore”

¹⁶. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Dokument i MAS. 2014. <http://www.izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Korniza-Kurrikulare.pdf>

¹⁷. <http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-1-5.pdf>

¹⁸. Shkresë zyrtare e MAS datë 07.10.2014, me Nr.6608/1 prot., “Miratim i planeve mësimore të medreseve” drejtuar Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH).

për klasat 1-5 (cikli fillor), “Edukata qytetare” për klasat 6-9 (cikli i mesëm i ulët), “Qytetaria” për klasat 10-11 (cikli i mesëm i lartë).

Reformimi i vijueshëm ndër vite i kurrikulës së arsimit parauniversitar ka sjellë që në 3 vitet fundit 2014-2016 të kemi fushën kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi”, brenda së cilës kanë vend lëndët e historisë, gjeografisë, edukimit për shoqërinë dhe qytetaria.

Në ciklin fillor (klasat 1-5) raporti i vendit, që zë në kurrikul fusha kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi” me lëndët e saj, që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me edukimin qytetar, sipas planit mësimor zyrtar rezulton të zërë 6% krahasuar me fushat e tjera kurrikulare dhe lëndët e tyre përbërëse në tërësi.

Në ciklin e mesëm të ulët (klasat 6-9) raporti i vendit që zë në kurrikul fusha kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi” me lëndët e saj që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me edukimin qytetar, sipas planit mësimor zyrtar rezulton të zërë 6% krahasuar me fushat e tjera kurrikulare dhe lëndët e tyre përbërëse në tërësi.

Në ciklin e mesëm të lartë (klasat 10-12) raporti i vendit që zë në kurrikulën bërthamë/bazë fusha kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi”¹⁹ me lëndët e saj, që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me edukimin qytetar, sipas planit mësimor zyrtar rezulton të zërë 16% krahasuar me fushat e tjera kurrikulare dhe lëndët e tyre përbërëse në tërësi.

Pra vërehet një rritje nga cikli në cikël gjatë arsimit parauniversitar i peshës specifike që zë kurrikula e edukimit qytetar në arsimin parauniversitar.

¹⁹. <http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-1-5.pdf>
<http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-6-9.pdf>

Po të analizojmë vetëm vendin dhe peshën që zënë lëndët e mirëfillta të edukimit qytetar si: “Edukim për shoqërinë”, “Qytetaria” në të tria ciklet e arsimit parauniversitar do të kishim të dhënat e mëposhtme:

Sipas planit të ri mësimor zyrtar të arsimit parauniversitar, që zhvillohet aktualisht në klasat 1-2 të ciklit fillor, zhvillohet lënda “Edukim për shoqërinë”, ndërsa nga klasa 3-10 zhvillohet lënda “Qytetaria”.

Klasat 1-5 të ciklit fillor

Nr	Lëndët	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Klasa 4	Klasa 5
1	Edukim për shoqërinë	1 orë/javë	1 orë/javë	-	-	-
2	Qytetari	-	-	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë

Raporti i orëve të lëndëve “Edukimi për shoqërinë” dhe “Qytetaria” krahasuar me numrin total të orëve të planit mësimor të këtij cikli rezulton 0,23 %.

Klasat 6-9 të ciklit të mesëm të ulët

Nr	Lënda	Klasa 6	Klasa 7	Klasa 8	Klasa 9
1	Qytetari	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë

Raporti i orëve të lëndës “Qytetaria” krahasuar me numrin total të orëve të planit mësimor të këtij cikli rezulton 0,30 %.

Klasat 10-12 të ciklit të mesëm të lartë²⁰

Nr	Lëndët	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
1	Qytetari	2 orë/javë	-	-

Raporti i orëve të lëndës “Qytetaria” krahasuar me numrin total të orëve të planit mësimor të këtij cikli rezulton 0,35 %.

Fusha kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve Edukim për shoqërinë, Qytetari, Histori, Gjeografi. Secila prej tyre e trajton botën dhe shoqërinë nga këndvështrime të ndryshme. Përmes kësaj fushe, nxënësi zhvillon bazat e qytetarisë, duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to; zhvillon konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot; zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime, që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

Programet e lëndëve “Edukim për shoqërinë”, “Qytetari”, “Gjeografi” dhe “Histori” janë ngushtësisht të lidhura me kompetencat, që ato synojnë të zhvillojnë te nxënësi. Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni, në këtë

²⁰. <http://www.izha.edu.al/wp-content/uploads/2014/10/Udhezues-per-gjimnazin-Varianti-i-fundit.pdf>

shkallë, i shërbejnë përmbushjes së kompetencave kyçe, evropiane me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor. Lëndët që përbëjnë fushën “Shoqëria dhe mjedisi” zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një shoqëri demokratike. Ato nxisin zhvillimin intelektual të nxënësit, duke i dhënë mekanizmat konceptualë dhe metodologjikë, të cilat nxënësi mund t’i përdorë në situata të ndryshme dhe që e ndihmojnë të prezantojë botën dhe të përballojë situata të ndryshme në jetën e tij. Tematika e trajtuar në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” përmes lëndëve të saj, ku edhe “Edukimi për shoqërinë” dhe “Qytetaria” bëjnë pjesë, ka të bëjë me:

1. Pushteti, autoriteti, qeverisja
2. Proceset natyrore dhe shoqërore
3. Kultura
4. Ndërvarësia njerëz-vende-mjedise
5. Kronologjia, ndryshimi, vazhdimësia
6. Individët, grupet, shoqëria
7. Prodhimi, shpërndarja, konsumi

1.1.1 Programet e edukimit qytetar

Programet e lëndëve “Edukim për shoqërinë”, “Qytetari” mbështeten tërësisht në konceptet dhe praktikat e qytetarisë demokratike. Qytetaria demokratike bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe të shtetit të së drejtës. Ajo lidhet, para së gjithash, me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin qytetar, pjesëmarrjen dhe

përkatësinë, respektin për diversitetin. Si e tillë, ajo përfshin të gjitha grupet shoqërore dhe sektorët e shoqërisë. Qytetaria demokratike bazohet në një metodë shumëpërmasore, që ka në bazë procesin dhe përfshin:

- *Përmasën politike*, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik.
- *Përmasën ligjore*, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve.
- *Përmasën kulturore*, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore.
- *Përmasën shoqërore dhe ekonomike*, veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve dhe si ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike.
- *Përmasa evropiane*, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian.
- *Përmasën globale*, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvlerësive dhe solidaritetit global.

Edukimi për qytetari demokratike synon:

- Të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;

- Të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- Të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;
- Të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike.

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, programet e lëndëve të qytetarisë synojnë:

- T'u japin nxënësve mundësinë për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre.
- T'u japin nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.
- T'u japin nxënësve mundësinë të zhvillojnë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

Lëndët “Edukim për shoqërinë” dhe “Qytetaria”²¹ gjithashtu synojnë të përmbushin edhe njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e kompetencave zyrtare, kyçe për arsimin parauniversitar, përkatësisht:

²¹. <http://www.izha.edu.al/programe-lendore/programet-e-arsimit-baze-kurrikula-e-re/#feature3>

1. Kompetenca qytetare
2. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit
3. Kompetenca e të menduarit
4. Kompetenca e të nxënit
5. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
6. Kompetenca personale
7. Kompetenca digjitale

Temat që zhvillon lënda e qytetarisë prekin çështje të tilla që lidhen thelbësisht me edukimin qytetar, si:

1. Ligji
2. Kushtetuta
3. Të drejtat e njeriut
4. Arsimi
5. Shëndeti
6. Mjedisi
7. Konsumatori
8. Puna dhe e drejta e punës
9. Siguria në rrugë
10. E drejta për informim dhe ligji për median
11. Bashkëjetesa në komunitet

Nga ana tjetër, lëndët “Edukimi për shoqërinë” dhe “Qytetaria” zhvillojnë edhe veprimtari mësimore ndërkurrikulare, që trajtojnë tema

madhore, me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndëve “Edukim për shoqërinë” dhe “Qytetaria” fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Mjedisi
- Ndërvarësia
- Bashkëjetesa paqësore

Rolet dhe kompetencat e mësuesit për realizimin e mësimdhënies dhe mbështetjen e proceseve të të nxënit në fushën e qytetarisë kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

- *dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta*
- *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj,*
- *synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive.*
- *aftësinë për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia*

për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tijat;

- aftësinë për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, si dhe ndërmjet nxënësve; respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;*

- aftësinë për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse, që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;*

- aftësinë për ta parë veten dhe nxënësin, si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar; bindjen në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;*

- aftësinë për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;*

- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësimë prej tyre;*

- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuara nga kurrikula e fshehtë.*

Aspekt tjetër, i theksuar, i kurrikulës së edukimit qytetar është trajtimi i nxënësve me nevoja të veçanta dhe ai i nxënësve të talentuar, e cila kërkon që mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motive, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Nga ana tjetër mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe

të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës.

’’Dallimi mes ambicies politike dhe aktivizmit fetar është thelbësore për një kuptim korrekt të misionit të Gylenit. Për shembull, Gyleni nuk e shikon botën në terma politikë dhe nuk vizaton/ndërton kufij imagjinarë. Siç është shprehur me mjeshtëri nga Klas Grinell në këtë libër, Gyleni është një ‘’transgresor kufinjsh’’. Duke përdorur ixhtihadin, ai e bazon këtë transgresion kufinjsh në kuptimin e –dhe gjithashtu shtrihet te -jurisprudencës Islame (fiqh).

¹⁰² Hindī, ‘Alāuddīn ‘Alī al-Muttaqī b. Husamaddīn (d. 975), *Kanz al-‘ummāl fī Sunan al-aqwāl wal-af‘āl*, (ed. Bakrī Ḥayyānī, Ṣaffat as-Saqā), 5.ed. (Beirūt: Muassasat ar-Risāla, 1985/1401), I, 142.

¹⁰³ Jilmaz, "Inovacioni Social për Bashkëjetesë Paqësore: Aktivizmi ndërkulturor Nga Rumi te Gyleni"; Shih gjithashtu: Elisabeth Ozdalgā, "asketizmi i kësaj bote në kastën islame: devotshmëri dhe aktivitet të frymëzuar nga Fethullah Gylenit", Kritikë: Critical Mesme Studimet e Lindjes, Vol. 9, Lëshimi 17 (2000), 84-104.

Ai nuk e ndan botën duke përdorur koncepte të përbashkta ekskluzive të dar-ul harb (tokë e luftës) dhe *dar-ul islam* (tokë e paqes), por e shikon atë si një vend pothuajse koherent, siç ka qenë, që nevojitet të shërbehet vazhdimisht duke përdorur konceptin dar-ul hizmet (tokë e shërbimit për njerëzimin, në këtë mënyrë Zotit): nëse qëllimi i dikujt është t'i shërbejë Islamit duke prezantuar/paraqitur një shembull të bukur, atëherë njëri mund të qëndrojë kudo që dikush dëshiron, thotë Abdullah Ajmaz, ish-kryeredaktor i të përditshmes *Zaman*, mik i ngushtë i Gylenit dhe koleg për më shumë se tridhjetë vjet.¹⁰⁴

Përfundimi

Kur'ani është një dokument pluralist. Ai thotë që/se çdo fe e mirëudhëzuar/në rrugë të drejtë vjen nga Zoti dhe nuk duhet të ketë shtrëngim/dhunë në fe. Thotë gjithashtu se Muhamedi (paqja e Zotit qoftë mbi të) nuk ka ardhur të anulojë mësimet e Ibrahimit, Musait, dhe Isait (paqja e Zotit qoftë mbi gjithë ato). Gyleni thekson se: "Islami i njeh të gjitha fetë paraardhëse. Ai pranon gjithë profetët dhe librat, të dërguara në epoka të ndryshme të historisë. Jo vetëm i pranon ato, por gjithashtu kërkon besim në to, si një princip esencial për të qenë mysliman. Duke bërë kështu, ai pranon unitetin themelor të feve me shpallje hyjnore. Një mysliman në të njëjtën kohë është një pasues i vërtetë i Ibrahimit, Musait, Davudit, Isait dhe gjithë profetëve tjerë (hebrenj). Ky besim shpjegon pse kristianët dhe hebrenjtë gëzuan të drejtat e feve të tyre respective, nën drejtimin e qeverive islame

¹⁰⁴ Ihsan Yilmaz, "Inovacioni Social për Bashkëjetesë Paqësore: Aktivizmi ndërkulturor Nga Rumi te Gyleni".

përgjatë historisë.”¹⁰⁵ Ideja se ju të gjithë duhet të bëheni/jeni myslimanë është në fakt kundër mësimëve eksplicite të Kur’anit në të cilën Zoti i thotë Muhamedit (paqja e Zotit qoftë mbi të) se nëse Ne (përdor mënyrën mbretërore) do të dëshironim që e gjithë raca njerëzore të ishte në një komunitet të vetëm fetar, Ne mund ta kishim bërë të atillë, por Ne nuk dëshiruam ashtu. Kjo nuk ishte dëshira jonë kështu që ju, Muhamed (paqja e Zotit qoftë mbi të), lëri ato.

Kur’ani thotë se çdokush ka fenë (dinin) e tij, traditat fetare të tij, mënyrën e tij të jetesës. Pikërisht kjo është duke humbur në botën modern. Kjo ishte gjithashtu një praktikë myslimane për qytetërimin e hershëm Islam. Në perandoritë që ato formuan, konvertimi në Islam nuk ishte në fakt një çështje shtrëngimi/dhune. Sepse hebrenjtë, kristianët, zoroastrianët dhe me vonë budistët kishin besimin dhe traditat e tyre dhe kjo ishte që të respektohen.

¹⁰⁵ M. Fethullah Gülen, *Ese, Perspektiva, Opinione M. Fethullah Gülen* (New Jersey: Tughra Books, 2010), 20-21.

BIBLIOGRAFIA

Muslim, Abū al-Ḥusain Muslim b. Ḥajjāj b. Muslim al-Qushayrī an-Nīsābūrī. *al-Cāmi' aṣ-ṣaḥīḥ*. Beirūt: Dār al-Jīl, n.d.

‘Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut,’ Kombet e Bashkuara
Nissim Rejwan, Shumë fytyra të Islamit: Perspektivat e një qytetërim të rilindur.

Mark Silk, "Përcaktimi Pluralizmi fetar në Amerikë: Një Analizë rajonale", analet e Akademisë Amerikane të Shkencave Politike dhe Sociale

Jilmaz, "Inovacioni Social për Bashkëjetesë Paqësore: Aktivizmi ndërkulturor Nga Rumi te Gyleni"

M. Fethullah Gülen, *Ese, Perspektiva, Opinione*

Hindī, ‘Alāuddīn ‘Alī al-Muttaqī b. Husamaddīn (d. 975), *Kanz al-‘ummāl fī Sunan al-aqwāl wal-af‘āl*, (ed. Bakrī Ḥayyānī, Ṣaffat as-Saqā), 5.ed. (Beirūt: Muassasat ar-Risāla, 1985/1401).

Elisabeth Ozdalga "Asketizmi ndaj botës në Kallëpet islame: Fethullah Gylen frymëzoi Dhembshuri dhe Aktivizëm", Kritikë: Rëndësia Kritike e Studimeve të Lindjes së Mesme

Ihsan Yilmaz, "Ixhtihadi dhe Taxhdidi nga një sjellje: Lëvizja Gylen" në M. H. Yavuz dhe J. L. Esposito (eds) *Islami turk dhe shtetit laik: Lëvizja Gylen* (të Syracuse, Nju Jork: Syracuse University Press, 2003

al-Alwānī, "Globalizimi: Centralizim, jo Globalizëm"

Al-Mawsū‘a al-fiqhiyya al-Kuwaytiyya (The Kuwaiti Encyclopedia of Fiqh) (Kuwait: Wizāra al-awqāf wash-shu‘ūn Al-Islāmiyya)

Albajrak, "Një perspektivë myslimane në dimensionin etik të jetës".

al-Bayhaqī, Abū Bakr Aḥmad b. Ḥusain (458/1065), *Shu‘ab al-īmān*, (ed. Abū Ḥajar Zaghlūl) (Beirūt: Dār al-Kutub al-‘Ilmiyya, 1990/1410), IV, 286.

Bukhārī, Muḥammad b. Ismā‘īl, (ed. Muṣṭafā Dīb al-Bugha), *Ṣaḥīḥ al-Bukhārī* (Beirūt: Dār Ibn Kathīr, 1987/1407), Adab, Bāb: 57.

(المسلم من سلم الناس من لسانه ويده والمؤمن من أمانه الناس على دمائهم وأموالهم) Abū Abdir Raḥmān Aḥmad ibn Shu‘aib an-Nasa’ī (215- 303 AH), *Sunan an-Nasa’ī*, (ed. ‘Abdul Fattāḥ Abū Ghudda), (Ḥalab: Maktabat al-Matbū‘āt al-Islāmiyya, 1986/1406), Kitāb al-Īmān wa Sharā’i‘ihī, Bāb: 8.

Fethullah Gyleni, "Një Shpirt i Devotshmërisë për një jetë", shtambë e thyer, 12 tetor 2014, arrihen prill 07, 2015, <http://www.herkul.org/weekly-sermons/a-spirit-of-devotedness-për-një-jetës/>.

Dr. Adil Kutlu, KU Bedër

Disa qasje sociologjike mbi dukurinë Fe

akutlu@beder.edu.al

Abstrakt

Si rezultat i zhvillimeve të përjetuara në shkencë, industri dhe teknologji është siguruar mirëqenia materiale e njeriut. Feja, që dikur ishte aktive në çdo fushë të jetës, tashmë pranohej si “jashtë kohe apo mode” dhe është përballur me lënien e saj jashtë jetës sociale. Veçanërisht duke filluar nga shekulli XVIII, shumë shkencëtarë, të cilët punonin në fusha të ndryshme të shkencave sociale në Evropë, kanë kontribuar në formimin e kësaj situate. Iluministët, të cilët i vunë vulën të shkuarës së afërt, që ndikuan thellë tek masa të tëra njerëzish, mbi idetë e të cilëve u themeluan sisteme, paraqitën qasje të reja të ndryshme ndaj dukurisë *fe*.

Jemi të mendimit se cekja shkurtimisht e qasjeve ndaj dukurisë fe të Auguste Comte, Karl Marks, Emile Durkheim, Maks Weber, Joachim Wach do të na ndihmojë për të kuptuar pozitën e fesë në ditët e sotme.

1. Auguste Comte (1798-1857)

Karakterin themelor të shoqërisë së Evropës së Mesjetës e formon perceptimi fetar që komentonte Kisha Katolike si dhe rëndësia që u jepej luftëtarëve. Sipas Auguste Comte, tipi i shoqërisë që kryesonte, i shoqërisë së kompletuar me karakteristika fetare dhe ushtarake, po hiqet dhe vendin e saj po e zë shoqëria e shkencës dhe industrisë. Ndërkohë që në periudhat e kaluara ndikimin më të madh e kishin format e mendimit të teologëve, tashmë rëndësi

të madhe kishte këndvështrimi dhe mendimi i shkencëtarëve. Kjo do të thoshte se në epokën e re vendin e teologëve e kishin zënë shkencëtarët. Nga ana tjetër, vendin e klasës ushtarake e zunë industrialistët, sipërmarrësit, drejtorët e fabrikave dhe punonjësit e bankave, sepse, kur njerëzit fillojnë të mendojnë shkencërisht, lufta del nga të qenit një aktivitet mes shoqërisht dhe në vend të saj kalon përdorimi me zgjuarsia i burimeve natyrore.¹⁰⁶

Në fillimet e shekullit XIX, të gjithë të shquarit francezë ishin në kërkim të gjetjes së një zgjidhjeje për problemet shoqërore. Ndërkohë që një pjesë e tyre zgjidhjen e kërkonte në kthimin mbrapa në regjimet e vjetra mbretërore-fetare, pjesa tjetër mendonte se zgjidhja duhej kërkuar në një feja të ri. Në këtë pikë duket edhe përpjekja e Comte-s për t'i bashkuar këto dy rryma të pozitivizmit. Comte, i cili nuk hiqte dorë as nga tradita, as nga përparimi dhe reforma, nga njëra anë bashkë me tradicionalistët besonte në domosdoshmërinë e fesë dhe autoritetit, nga ana tjetër vepronte me revolucionarët dhe ndërkohë i jepte rëndësi reformës.¹⁰⁷

Comte pohon se feja, që sipas tij është një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e njerëzimit, i lidh njerëzit me njëri-tjetrin në çdo periudhë dhe kontribuon në rregullimin e shoqërisë. Gjithashtu ai mendon se për të dalë nga depresioni ku ka rënë, njeriut duhet t'i gjendet një fe e re. Sipas Comtes, feja nuk duhet të jetë si fetishizmi, politeizmi apo monoteizmi që tashmë i ka ikur moda. Sot, për një fe të re nuk mjafton vetëm fakti se ajo mund të jetë e

¹⁰⁶ Aron, Raymond, *Sosyoloji Düşüncenin Evreleri*, Bilgi Yayınevi, İstanbul, 1989: 61.

¹⁰⁷ Kösemihal, Nurettin, Şazi, *Durkheim Sosyolojisi*, Remzi Kitabevi, İstanbul, 1971: 151,152.

pranueshme, por ajo duhet që t'i vërtetojë dhe t'i mbështesë të vërtetat pozitive.¹⁰⁸

Comte, mendimet e tij rreth fesë i analizon si periudha teologjike, metafizike dhe pozitive, të cilat ai i sqaron si “ligji i tre gjendjeve”. Sipas kësaj, Comte mendon se periudha teologjike, e cila është edhe forma më primitive, përbëhet nga disa hapa, fillon me fetishizmin, që është besimi tek i cili të gjitha qeniet konsiderohen të gjalla dhe ngjarjet drejtohen prej tyre, vazhdon me politeizmin dhe në fund plotësohet dhe përsoset me monoteizmin. Në periudhën metafizike, dëshirat e perëndive kalojnë në formën e ligjeve dhe forcës së fshehtë. Si pasojë, në këtë periudhë shumë akte dhe funksione i ngarkohen natyrës. Ndërsa në periudhën pozitive, hiqen paqartësitë e periudhës teologjike dhe metafizike. Tashmë, ngjarjet sqaroheshin me ligje pozitive mes fenomenesh.¹⁰⁹

Sipas Comtes, me Rilindjen, u kalua nga periudha teologjike në atë metafizike dhe me Revolucionin Francez u kalua në periudhën pozitive.¹¹⁰ Te vepra e Comtes me titull “Katekizmi i pozitivizmit”, nga fjalët e priftit: “Bija ime, ne bëjmë adhurime që duke e përmirësuar më shumë veten t'i shërbejmë njerëzimit dhe jo për t'u pëlqyer siç bëhej me Perëndinë e Vjetër”,¹¹¹ duket qartë se Comte mendon për një Zot të ri për shoqërinë. Sipas Raymond Aronit, Comte, po të mos e dashuronte vajzën me emër Clotilde de

¹⁰⁸ Kılıç, Ahmet, Faruk, Toplumun Direği Din, Kutup Yıldızı Yayınları, İstanbul, 2014: 39,40.

¹⁰⁹ Gökberk, Macit, Felsefe Tarihi, Remzi Kitabevi, İstanbul, 1990: 466.

¹¹⁰ Kösemihal, Nurettin, Şazi, Durkheim Sosyolojisi, Remzi Kitabevi, İstanbul, 1971: 157.

¹¹¹ Comte, Auguste, Pozitivizm İlmihali, (përkth.) Peyami Erman, Milli Eğitim Basımevi, İstanbul, 1986: 46.

Vaux, ndoshta nuk do të haronte apo planifikonte diçka të tillë si fe njerëzore. Prandaj mendohet se kjo fe ka të bëjë edhe me historinë e jetës së Comtes.¹¹²

2. Karl Marks (1818-1883)

Në mendimet e Karl Marksit, i cili është një ndër përfaqësuesit më të rëndësishëm të teorisë kontradiktore në sociologji, kanë ndikuar personalitete si Sain Simon, Feuerbach, Darwin, Renan, Ricardo, Sismodi. Shihet që Marks më tepër është ndikuar nga Hegeli (1770-1831). Për të kuptuar Marksit, është e nevojshme që të njihen mendimet e Hegelit. Sipas Hegelit, çdo gjë eksistente në univers në vetvete ka të kundërtën e saj dhe çdo gjë është në një përplasje me veten. Edhe lëvizja në univers, lind nga përplasja e të kundërtave me njëra-tjetrën. Sipas Hegelit, i cili pranon se burimi i të gjitha qenieve është një mendim universal, burimi i jetës nuk është materia por sensi, kuptimi. Ndërsa materia ka lindur nga sensi. Sipas filozofisë së Hegelit, mendimi universal ekziston vetvetiu dhe nga ky mendim kanë dalë në pah qenie materiale. Në këtë mënyrë fillon procesi i tjetërsimit të mendimit universal me vetveten.¹¹³

Marks, i cili ka kthyer në të kundërt filozofinë idealiste (që mbështetet në mendim) të Hegelit, e ka shndërruar atë në një filozofi materialiste (që mbështetet në materie) dhe këtë e ka shprehur kështu: “E vendosa me këmbë në tokë dialektikën që ecte me këmbë përpyetë”. Sipas Marksit, burimin e të gjitha qenieve e formon materia, madje edhe mendimet,

¹¹² Aron, 1989: 90.

¹¹³ Kılıç, 2014: 42.

të gjitha qeniet shpirtërore janë prodhuar nga materia.¹¹⁴ Marksi, që mendon se elementet që përcaktojnë fatin e njerëzimit, i cili po ndryshon vazhdimisht për mirë, janë metodat ekonomike të prodhimit, pretendon se në formimin dhe ndryshimin e shoqërive faktori kryesor që ndikon është ekonomia dhe se të gjithë faktorët e tjerë janë të lidhur pas ekonomisë. Sipas tij, edhe shkakun e luftërave dhe konflikteve, si dhe infrastrukturën e institucioneve shoqërore e përbën ekonomia. Të gjitha institucionet që mbeten jashtë ekonomisë si edukimi, familja, feja, jurisprudenca, morali, ideologjitë, etj, janë superstrukturore. Kështu që, në një shoqëri rëndësi ka infrastruktura. Pa u kuptuar infrastruktura ekonomike, nuk mund të shpjegohet superstruktura.¹¹⁵

Pavarësisht se qasjet e Marksit ndaj fesë patën ndikim në shoqëri, nuk mund të thuhet se ai e analizon fenë në mënyrë të detajuar, sepse Marksi ka përfituar nga mendimet e Ludwig Feuerbach në aspektin fetar. Sipas Feuerbach, feja formohet nga mendimet dhe vlerat që njerëzimi prodhon gjatë procesit të zhvillimit kulturor, por këto vlera e mendime u atribuohen perëndive ose forcave hyjnore në mënyrë të gabuar. Feuerbach, që e vlerëson këtë situatë si një proces tjetërsimi, mendon se edhe kuptimi i tjetërsimit nga shoqëria është shpresëdhënës, sepse njerëzit, kur të kuptojnë se vlerat të cilat ata ia dedikojnë fesë janë vlerat e tyre, për t'i realizuar këto vlera nuk do të ishin të detyruar të prisnin jetën e përtejme.¹¹⁶

¹¹⁴ Ergun, Doğan, 100 Soruda Sosyoloji El Kitabı, Gerçek Yayınevi, İstanbul, 1984: 34,35.

¹¹⁵ Kılıç, 2014: 43.

¹¹⁶ Giddens, Anthony, Siyaset, Sosyoloji ve Toplumsal Teori. Tuncay Birkan (përkth.), Metis Yayınları, İstanbul, 2001: 583.

Marks, që në veprat e tij flet për shtresat sipas profesioneve, ai veçanërisht flet edhe për tipe të ndryshme shoqërish. Sipas Marksit, i cili i cilëson shoqëritë primitive komunale dhe ato socialiste si shoqëri ideale, në këto lloje shoqërish nuk ka konflikte mes klasash. Në këto shoqëri ka pronësi të përbashkët, madje edhe fëmijët që lindin i përkasin shoqërisë. Institucione si shteti, familja, feja, arsimimi etj. kanë lindur si rezultat i tjetërsimit të njerëzve me veten e tyre dhe janë bërë vegël e shfrytëzimit. Këto institucione, duhet të eliminohen kur të themelohet shoqëria socialiste.¹¹⁷

Marks, i cili ka qasje negative ndaj fesë, fenë e sheh si një infrastrukturë të prodhuar për të vazhduar rregullin e formuar mbi themelet e padrejtësisë. Sipas tij, feja që është rënkimi i shtresave nën presion, ka mpirë popullin.¹¹⁸ Nëse do ta shprehnim sipas thënies së famshme të Marksit, feja është “opiumi i popullit”. Sipas tij, feja, duke e lënë mënjanë angazhimin me kushtet e kësaj bote, të mëson sesi t’i shtysh për jetën pas vdekjes lumturinë dhe shpërblimet. Për këtë arsye, pengohet ndalimi i pabarazisë dhe padrejtësisë së kësaj bote dhe njerëzit mashtrohen me premtimet e jetës së përtejme.¹¹⁹ Sipas tij, megjithëse në shoqëritë kapitaliste ata që bëjnë prodhimin janë më të shumtë, mjetet e prodhimit kontrollohen nga pakicat. Pavarësisht se kapitalistët janë në pakicë, në mënyrë që ata të vazhdojnë presionin mbi shumicën dhe të pengojnë shumicën që ta kuptojë këtë kontradiktë, kanë krijuar një metafizikë, një fe dhe moralin. Ky sistem i krijuar, i shërben përfitimeve të klasës së pakicës që është në pozicionin e të shtypurit. Marks

¹¹⁷ Kılıç, 2014: 44.

¹¹⁸ Şenel, Adnan, Doğu ve Batı'da Düşüncenin Temelleri, Kamer Yay., İstanbul, 1993: 160.

¹¹⁹ Giddens, Anthony, Sosyoloji. Hüseyin Özel dhe të tjerë (përkth.), Ayraç Yayınevi, Ankara, 2000: 470.

beson se për shkak të këtij ndikimi mbi njeriun feja është kthyer në një idhull që s'është më dobi për njerëzimin, prandaj për ta zgjuar njerëzimin duhet që ajo të eliminohet menjëherë. Duhet të eliminohen idhujt dhe besimet e pavenda për ta shpëtuar klasën punëtore të robëruar nga presionet që shkaktojnë shfrytëzim dhe kjo detyrë i takon klasës punëtore.¹²⁰

3. Emile Durkheim (1858-1917)

Emile Durkheim mendimet e tij mbi fenë i ka shprehur në librin me titull "Format primitive të jetës fetare". Durkheim është i bindur se për kuptimin më të qartë të dukurisë "fe", që është dhe tematika kryesore e veprës së tij, duhet të analizohen edhe fetë më primitive. Durkheim arsyen e këtij mendimi e mbështet në idenë se fetë e ditëve të sotme kanë arritur deri më sot duke kaluar faza të ndryshme dhe për kuptimin më të qartë të strukturave të tyre komplekse duhet të analizohen nga aspekti historik, duke filluar nga statet e tyre para se të evoluonin deri te gjendja e tyre në kohët tona.¹²¹

Sipas Giddens, Durkheim me këtë synim ka analizuar edhe totemizmin e parë në shoqëritë vendase të Australisë. Durkheim, pretendon se totemizmi është forma më primitive dhe origjinale e fesë dhe këtë e ka bërë titull libri. Përsa i përket totemit, totemi është një kafshë ose bimë, simbol i një grupi nga të cilët i jepet shumë rëndësi. Totemi që shihet si i shenjtë respektohet dhe në emër të respektit ndaj tij kryhen rituale të ndryshme. Durkheimi që shpjegon se pse është i shenjtë totemi, arsyen e shenjtërisë e lidh me faktin se totemi përfaqëson vlerat themelore të një grupi dhe faktit se është

¹²⁰ Akın, İlhan. F., Devlet Doktrinleri, Samim Güniz Basımevi, İstanbul, 1962: 234-236.

¹²¹ Kösemihal, 1971: 99.

simbol i atij grupi. Ne fakt, arsyeja që totemit i tregohet respekt i madh, buron nga respekti që tregohet ndaj vlerave shoqërore themelore. Objekti që adhurohet në fe, në të vërtetë është vetë shoqëria.¹²²

Sipas Durkheim, dihet qëkur se mendimet e njeriut rreth botës dhe vetes së tij mbështeten në fe. S'ka asnjë fe që ndërkohë që pretendon për vegime mbi Perëndinë, të mos merret edhe me ligjet që drejtojnë universin. Në fillim feja, ngaqë zinte vendin e shkencës dhe filozofisë, sepse filozofia dhe shkenca kanë lindur nga feja. Feja, ka kontribuar jo vetëm për zhvillimin e objektit të dijes sonë, por edhe për zhvillimin e formave që e përpunojnë këtë dije. Në rrënjët e gjykimeve tona ndodhen një sërë koncepte themelore si koha, vendi, lloji, arsyeja etj. që sundojnë në botën tonë të mendimeve. Që në kohën e Aristotelit këto janë quajtur kategori, forma apo modele të mendimit. Pra, kur analizohen fetë primitive ndeshet me gjurmët e turbullta të këtyre kategorive. E thënë ndryshe shihet se këto kategori vijnë nga feja dhe burimi i tyre është vetë feja.¹²³

Durkheim, që ne veprën e tij përmend dukurinë fe dhe qasjet e ndryshme në lidhje me përkufizimin e fesë, e ka kritikuar analizimin e fesë si një tërësi të pandashme dhe jo si një përbërje nga pjesë si miti, ceremonia fetare, dogma etj. Sipas tij, një e plotë mund të shpjegohet vetëm me anë të lidhjes së saj me copëzat që e formojnë atë. Në këtë situatë, ajo që duhet të

¹²² Giddens, 2000: 471.

¹²³ Durkheim, Emile, *Les Formes Elementaires de la Vie Religieuse*, Quadrige/Presses Universitaires de France, (përkth. N. Saruhan), Paris, 1990: 12-13.

aplikohet si metodë është që për ta kuptuar të tërën si fillim duhen analizuar mirë pjesët përbërëse të saj.¹²⁴

Durkheim që mendon se individët lindin nga shoqëria dhe jo shoqëria nga individët, për të vërtetuar vërtetësinë e këtij mendimi, është munduar që ta kthejë në metafizikë konceptin "ndërgjegjja a kolektive". Sipas tij, i cili e bën të qartë se nuk sheh ndonjë ndryshim mes Perëndisë dhe shoqërisë, shoqëria zotëron forcën dhe kapacitetin për të ndikuar mbi individët ashtu siç ndikon edhe Perëndia. Atë që shpreh Zoti për besimtarët, për individët e shpreh edhe shoqëria, që shpreh të njëjtën gjë. Koshienca kolektive si Zoti është mbi koshiencën e individëve dhe ndikon mbi ta.¹²⁵

Durkheim që është i mendimit se shoqëritë apo bashkësitë i formojnë Perënditë dhe jo Perënditë bashkësitë, mbron idenë se shoqëritë njerëzore tregojnë tendencë për të formuar Perëndi ose fe në raste entuziazmesh që rrjedhin nga angazhimi i tepërt i jetës së përbashkët. Ai mendon se këtë funksion në shoqëritë tradicionale e kryejnë ceremonitë fetare, ndërsa në shoqëritë moderne momentet e entuziazmit të tepërt. Durkheim jep si shembull të momenteve të entuziazmit të tepruar që përjetohet në shoqëritë moderne dhe sipas tij aftësia e shoqërisë për ta hyjnizuar vetveten apo për të krijuar hyjni s'ka qenë asnjëherë më e qartë se në vitet e para të revolucionit. Me ndikimin e entuziazmit të përgjithshëm të atij momenti, gjëra plotësisht laike si atdheu, liria, mendja etj. nga ana e opinionit publik u kthyen në të

¹²⁴ Durkheim, 1990: 49.

¹²⁵ Ergun, 1984: 57.

shenjta dhe siç ndodh në një fe, shoqëria filloi të themelonte dogmën, simbolet dhe festat e veta.¹²⁶

Sipas Aronit, Durkheim, mendimin se feja është krijuar nga shoqëria e shpjegon nga aspekti socio-psikologjik. Sipas kësaj, ceremonia që është një aktivitet i përbashkët, e largon individin nga të qenurit vetëm dhe e hedh atë në forcën e grupit. Kështu që individi, futet në një gjendje komplet ndryshe nga ajo e jetës së tij rutinë. Kjo gjë e lartë dhe e jashtëzakonshme është forca e përbashkët dhe e shenjtë, pra këto dukuri janë shembull i procesit socialo-psikologjik që krijon fenë.¹²⁷

Sipas Giddens, Durkheimi beson se si rezultat i zhvillimit të shoqërive bashkëkohore, ndikimi i fesë është në zvogëlim e sipër. Sipas kësaj shpjegimet shkencore kanë zënë vendin e atyre fetare dhe bashkë me këtë ndryshim, vendi që do të zënë ceremonitë dhe ritualet në jetën e individit do të jetë i vogël. Veçanërisht Durkheimi mbështet mendimin e Marksit se feja tradicionale është në humbje e sipër.¹²⁸

4. Maks Weber (1864-1920)

Duke filluar nga kreu i shekullit XX, një ndër ngjarjet që tërhoqi më shumë vëmendjen ishte rritja e interesit të intelektualëve për fenë si dhe nevoja për kërkime që do të bëheshin në këtë fushë në shoqëritë moderne. Teksa sociologët e kohëve të fundit të shekullit XIX, fenë e shihnin si një ndodhi që në shoqëritë moderne po e humbet kuptimin e saj, në shekullin XX

¹²⁶ Aron, 1989: 251, 250.

¹²⁷ Aron, 1989: 250.

¹²⁸ Giddens, 2000: 471.

këto lloj mendimesh pozitiviste dhe në evoluim janë refuzuar fort dhe u hoq dorë nga fiksimi për të kërkuar burimin e fesë. Shkaku i kësaj mund të kërkohej në mbizotërimin e mendimit se këto tema nuk hyjnë në temat kryesore të sociologjisë së fesë.¹²⁹

Maks Weber pati shumë ndikim në qasjen se temat në lidhje me fenë duhen analizuar në kategorinë e ngjarjeve sociale. Weber, pranohet si themeluesi i sociologjisë fetare të parë sistematike dhe të pavarur. Weberi i cili ishte i lidhur me rrymën “Shkencat shpirtërore” që në historinë e sociologjisë vjen nga Dilthey dhe Rickert, ka përsosur traditën e sociologjisë, të cilësuar si “Sociologjia kuptuese”. Weber, në të njëjtën kohë ka treguar sukses edhe në aplikimin në studimet e sociologjisë fetare të “Metodës së kuptimit” e cila është klasifikimi i ngjarjeve sociale që si ngjarjet e tjera të shoqërisë shihen me syrin e “tipit ideal”.¹³⁰

Mendimet e Weberit rreth fesë ndryshojnë nga ato të Durkheimit. Weber është koncentruar më shumë të lidhja mes fesë dhe ndryshimit shoqëror, ndërsa Durkheim nuk e ka prekur shumë këtë temë. Weber mendon ndryshe edhe nga Marksi. Teksa Marksi mendon se feja është konservatore, ndryshe nga ai, Weber mendon se lëvizjet që frymëzohen nga feja sjellin ndryshime të mëdha shoqërore. Sipas kësaj, protestantizmi përbën burimin e kapitalizmit që lindi në perëndim.¹³¹

Weber edhe në çështjet e ekonomisë mendon ndryshe nga Marksi dhe Durkheimi. Teksa Marks pretendon se feja ka lindur si rezultat i faktorit

¹²⁹ Günay, Ünver, Din Sosyolojisi, İnsan Yayınları, İstanbul, 2012: 168.

¹³⁰ Günay, 2012: 168, 169.

¹³¹ Giddens, 2000: 472, 473.

ekonomi, Durkheimi pretendon se në shoqëritë primitive ekonomia ka lindur nga feja. Sipas Weber, të parit të njërës prej tyre si një funksion i thjeshtë i tjetrës është një komentim i njëanshëm gjë që, sipas tij, është e gabuar. Ai njërin nga këto mendime e sheh si dy skaje ekstreme. Ndërsa rruga e mesme është që feja dhe ekonomia në mënyrë reciproke t'i përshtaten njëra-tjetrës. Ndryshe nga Marksi dhe Durkheimi, Weber faktorin fe e sheh si një element të pavarur dhe përpiket ta tregojë ndikimin e saj mbi ngjarje të tjera sociale dhe kulturore. Weber që e studion fenë si element metodologjik me këtë synim, për të treguar edhe impaktet e fesë mbi jetën ekonomike, "moralin ekonomik të fesë " e ka bërë temë studimi. Sipas tij, në çdo fe, përveç besimit dhe adhurimeve, ekziston karakteristika e të dhënit një pikëpamje dhe këndvështrim të jetës. Tematika që ka studiuar Weber, është çështja nëse në aktivitetet e ndjekësve të fesë ka ose jo ndonjë sjellje ndaj aktiviteteve shoqërore që buron nga feja.¹³²

Me këtë qëllim ai ka bërë studime të gjera rreth disa feve. Ai ka bërë kërkime të detajuara duke u koncentruar te fetë më të përhapura dhe ato më me ndikim mbi historinë botërore si Hinduizmi, Budizmi, Taoizmi dhe Judaizmi i vjetër. Për ndikimin e Krishterimit mbi historinë e Perëndimit ai ka shkruar në veprën e tij me titull "Shpirti i protestantizmit dhe morali protestant", ndërsa për Islamin nuk e ka mbaruar dot studimin e planifikuar.¹³³

Weber, i cili e përkufizon kapitalizmin si një synues të një përfitimi të pafund dhe si ekzistenca e administrimeve që veprojnë sipas logjikës burokratike, mundohet që të bëjë një lidhje mes fesë dhe ngjarjeve

¹³² Kılıç, 2014: 66-67.

¹³³ Giddens, 2000: 472.

ekonomike. Sipas teorisë së tij, mes filozofisë së Protestantizmit dhe filozofisë së kapitalizmit ka një harmoni kuptimplotë.¹³⁴

Kapitalizmi modern, është një tentative ekonomike që drejtohet në një formë racionale dhe që është e ngritur mbi pronën private dhe parimet e shkencave ekzakte. Shpirti i kapitalizmit modern në të njëjtën kohë përbën edhe shpirtin e Protestantizmit.¹³⁵ Koncepti "moral protestant" që Weber përdor, në thelb është një filozofi kalviniste dhe është frymëzuar nga teksti "Njoftimi i Westminster".¹³⁶

Sipas kësaj filozofie, motivimi për sa i përket suksesit, buron nga dëshira për t'i shërbyer Perëndisë, kurse suksesi material i arritur komentohet si një shenjë e caktimit të Perëndisë.¹³⁷ Dhe sipas doktrinës së caktimit hyjnor, individi që beson në botën e mëkateve duhet të punojë për Perëndinë. Për sa kohë që arrihet sukses në aspektin ekonomik besohet se ky sukses vjen nga risku që jep Perëndia, kështu që individi për të shpëtuar nga frika që sjell paqartësia rreth shpëtimit, motivohet të punojë.¹³⁸

Sipas Giddens, Weberi, kërkimet që ai ka bërë rreth feve botërore i sheh si një projekt i vetëm. Kërkimi i tij rreth ndikimit të Protestantizmit mbi zhvillimin perëndimor është një përpjekje gjithëpërfshirëse që ndihmon të kuptojmë sesi filozofia apo mendime të ndryshme fetare drejtojnë jetën shoqërore dhe ekonomike. Sipas përcaktimeve të Weberi,

¹³⁴ Aron, 1989: 370, 372.

¹³⁵ Günay, 2012: 171.

¹³⁶ Aron, 1989: 372.

¹³⁷ Giddens, 2000: 473.

¹³⁸ Aron, 1989: 372, 373.

“Hinduizmi, realitetin material e koncepton si një perde që fsheh nga sytë interesat e vërteta të cilat duhet të orientohet njeriu. Edhe Konfucianizmi, më tepër se nxitjen për të sunduar botën në mënyrë aktive, vë në plan të parë jetesën në harmoni dhe i prish punë iniciativës për përpjekje që sigurojnë zhvillimin ekonomik. Megjithatë Kina ka qenë civilizimi më i fortë dhe më i zhvilluar nga aspekti kulturor, vlerat fetare që mbizotëronin kanë parë një funksion frenues për zhvillimin ekonomik. Weber, Krishtërimin e sheh si fe shpëtimi. Fetë e shpëtimit kanë aspektin "revolucionar", ndërkohë që fetë lindore mbanin qëndrim ndaj rendit të stabilizuar, Krishtërimi më shumë i jep rëndësi përpjekjes për të mos bërë mëkate dhe kështu mund të nxisë rebelimin ndaj rendit të stabilizuar”.¹³⁹

Weber, me siguri, shpreh një mendim të drejtë teksa pretendon se idealet fetare krijojnë një ndikim shqetësues mbi rendin shoqëror të stabilizuar dhe në shumicën e rasteve ndikim revolucionar.¹⁴⁰

5. Joachim Wach (1898-1955)

Wach, studenti i Weberit, si profesori i tij, është i lidhur me traditën "sociologji kuptuese". Sipas këtij këndvështrimi, të gjitha ngjarjet sociale shihen me syrin "tip ideal". Edhe ngjarjet fetare duke u parë me këtë sy, fillimisht bëhen përkufizime konceptuale dhe më pas realizohen kategorizime të detajuara. Duke u nisur nga kjo Wach, në mënyrë që të kuptohen më mirë sidomos mendimet e tij rreth sociologjisë së fesë, qëndron gjatë mbi eksperiencën fetare dhe format e shpjegimit të saj.¹⁴¹

¹³⁹ Giddens, 2000: 473.

¹⁴⁰ Giddens, 2000: 473-474.

¹⁴¹ Kılıç, 2014: 74.

Wach ka marrë për bazë përkufizimin e profesorit të tij Rudolf Otto sepse atë e sheh si më objektiv. Feja, sipas Ottos, është "eksperienca e së shenjtës". Kjo eksperiencë është një sekret i frikshëm dhe mahnitës.¹⁴² Eksperiencë fetare do të thotë përjetimi i diçkaje në lidhje me sekretin që pranohet si i frikshëm dhe mahnitës nga ana e besimtarëve. Sipas tij, eksperiencia fetare ka tre forma shpjegimi: teorike, praktike dhe sociologjike.

a)- Shpjegimi teorik i eksperiencës fetare: Në të gjitha fetë pak ose shumë gjendet një përbërje teorike. Kjo përbërje mund të lindë edhe si sistem simbolesh.¹⁴³ Shtyllat e besimit të feve gjenden mes llojeve të adhurimeve dhe temave teorike në lidhje me kryerjen e tyre. Këto shpjegime teorike formohen nga tekstet e shenjta fetare dhe nga komentimet e mëvonshme të tyre.

b)- Shpjegimi praktik i eksperiencës fetare: Të gjitha veprat që lindin nga eksperiencia fetare janë shpjegimi praktik i fesë ose thënë ndryshe adhurimet. Të gjitha fetë respektin ndaj Perëndisë e tregojnë me anë të disa lëvizjeve që i përcaktojnë vetë ata.¹⁴⁴ Me kryerjen e adhurimeve që fetë kërkojnë nga besimtarët e tyre realizohet edhe shpjegimi praktik i eksperiencës fetare.

c)- Shpjegimi sociologjik i eksperiencës fetare: Një fe në jetë, është e detyruar të formojë lidhje sociale që i kërkon natyra e saj.¹⁴⁵ Kështu, shpjegimi teorik dhe praktik i eksperiencës fetare plotësohet me një shpjegim të tretë, atë sociologjik. Në fakt, shpjegimi sociologjik i përfshin shpjegimet

¹⁴² Wach, Joachim, Din Sosyolojisi, Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Yayınları, No: 98, İstanbul, 1995: 37,38.

¹⁴³ Wach, 1995: 46.

¹⁴⁴ Wach, 1995: 51-52.

¹⁴⁵ Wach, 1995: 54.

teorike dhe praktike. Dobitë e adhurimeve që bëhen me pasuri dhe me trup nuk janë studiuar në detaje as në librat e besimit e as në ato të katekizmit dhe në këtë fushë është krijuar një boshllëk i madh. Sipas Wach, këtë fushë boshe duhet ta mbushë sociologjia e fesë, sepse fusha e kryesore e sociologjisë së fesë është kjo shkencë e cila duhet të koncentrohet mbi shpjegimin sociologjik të eksperiencës së fesë në të gjitha fetë. Kjo qasje e tij ka bërë jehonë dhe sociologjia e fesë është pranuar si shkencë më vete.¹⁴⁶

¹⁴⁶ Kılıç, 2014: 76.

Bibliografia

Akın, İlhan. F., Devlet Doktrinleri, Samim Güniz Basımevi, İstanbul, 1962.

Aron, Raymond, Sosyoloji Düşüncenin Evreleri, Bilgi Yayınevi, İstanbul, 1989.

Comte, Auguste, Pozitivizm İlmihali, (përkth.) Peyami Erman, Milli Eğitim

Basımevi, İstanbul, 1986.

Durkheim, Emile, Les Formes Elementaires de la Vie Religieuse, Quadrige/Presses

Universitaires de France, (përkth. N. Saruhan), Paris, 1990.

Ergun, Doğan, 100 Soruda Sosyoloji El Kitabı, Gerçek Yayınevi, İstanbul, 1984.

Giddens, Anthony, Sosyoloji. Hüseyin Özel dhe të tjerë (përkth.), Ayraç Yayınevi,

Ankara, 2000.

Giddens, Anthony, Siyaset, Sosyoloji ve Toplumsal Teori. Tuncay Birkan (përkth.),

Metis Yayınları, İstanbul, 2001.

Gökberk, Macit, Felsefe Tarihi, Remzi Kitabevi, İstanbul, 1990.

Günay, Ünver, Din Sosyolojisi, İnsan Yayınları, İstanbul, 2012.

Kılıç, Ahmet, Faruk, Toplumun Direği Din, Kutup Yıldızı Yayınları, İstanbul, 2014.

Kösemihal, Nurettin, Şazi, Durkheim Sosyolojisi, Remzi Kitabevi, İstanbul, 1971.

Şenel, Adnan, Doğu ve Batı'da Düşüncenin Temelleri, Kamer Yay., İstanbul, 1993.

Wach, Joachim, Din Sosyolojisi, Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Yayınları,

No: 98, İstanbul, 1995.

MA. Gjenis Haxhimehmeti

Aspekte ligjore të bashkëpunimit ndërmjet shteteve të Unionit Evropian për menaxhimin e refugjatëve

Abstrakti

Luftërat e vazhdueshme në Lindjen e Mesme dhe shtete tjera në Afrikë dhe Azi, kanë bërë që Unioni Evropian të përballet me valë të madhe të refugjatëve. Kjo ka ndodhur si rezultat i afërsisë gjeografike mes vatrave të krizës dhe Unionit Evropian apo fuqisë ekonomike të shteteve evropiane. Përballimi i valëve të vazhdueshme të refugjatëve në vitet e fundit ka qenë jo lehtë i menaxhueshëm nga ana e shteteve anëtare të Unionit Evropian, pasi që implikimet kanë qenë të shumanshme duke përfshirë: sigurinë, ekonominë, qeverisjen e shteteve etj. Andaj përkundër faktit që e drejta ndërkombëtare e ka pasur të kodifikuar çështjet që ndërlidhjen me refugjatët, ligje të cilat janë të zbatueshme në vendet e UE-së, prapë për arsye praktike të menaxhimit të këtij fluksi refugjatësh, ka lindur nevoja që të hartohen një sërë rregullash ligjore nga ana e Unionit Evropian dhe vetë shteteve anëtare. Kjo ka bërë që të ngritën kapacitetet e shteteve brenda UE-së për bashkëpunimi ndërmjet tyre për menaxhimin e kësaj krize. Sigurisht që ky bashkëpunim i këtyre shteteve është shtrirë edhe me vendet tjera të prekura jashtë UE-së, siç është rasti i marrëveshjes UE-Turqi, të cilat kanë dhënë rezultate. Është me rëndësi të ceket se përveç aspekteve ligjore, kriza e refugjatëve dhe menaxhimi i saj ka sjellë implikime të thella diplomatike, të cilat kanë qar edhe në mosmarrëveshje ndërmjet shteteve sovrane të Unionit Evropian, të cilat burokracia e Brukselit është munduar t'i mbajë nën kontroll. Ky punim është

realizuar duke ndërthurur disa metoda shkencore me fokus metodën analizuese-sintetizuese dhe metodën e krahasimit,

Fjalët kyçe: e drejta ndërkombëtare, ligje, marrëveshje, refugjatët, Unioni Evropian.

Hyrje

Unioni Evropian është organizatë supranacionale me vendimmarrje të koklavitur mes institucioneve të ndryshme të saj, ca nga të cilat si Këshilli Evropian apo Këshilli i Ministrave mbrojnë interesat ndërqeveritare të shteteve anëtare, e ca institucione tjera si Komisioni apo Parlamenti mbrojnë interesat supranacionale. Evropa që nga e kaluara ka qenë pikësynim për refugjatë nga vatrat e ndryshme të krizës, ku shtetet e Evropës zakonisht i kanë mirëpritur këta refugjatë për arsye të vlerave evropiane të kodifikuara edhe në të drejtën ndërkombëtare humanitare, por edhe për shkak të interesit ekonomik dhe nevojës për fuqi punëtore të këtyre shteteve.

Termi refugjat ndryshon mjaft në kuptim, në varësi të faktit nëse përdoret në kontekstin e së drejtës ndërkombëtare publike (DNP) të përgjithshme apo në kontekstin e së drejtës ndërkombëtare humanitare (DNH). Në të drejtën ndërkombëtare publike termi është përkufizuar në raste të ndryshme me përpikmëri: ai zbatohet për çdo person që është larguar nga vendi i kombësisë së tij, për t'iu shmangur persekutimit ose kërcënimit të persekutimit (Konventa e Refugjatëve 1951, neni 1). Konventa e Organizatës së Unitetit Afrikan (1969) dhe më pas disa Rezoluta të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara e zgjeruan statusin e refugjatit duke përfshirë të gjithë personat që largohen nga vendi i tyre për shkak të një konflikti të armatosur ose trazirave të brendshme. Personat që përmbushin kushtet e vendosura në instrumentet ligjorë ndërkombëtare fitojnë statusin e refugjatit dhe të drejtat e detyrimet e caktuara. Megjithatë, e drejta ndërkombëtare humanitare nuk përmban ndonjë përkufizim të “refugjatit”. Në këtë të drejtë refugjati është mbi të gjitha një person civil dhe faktori vendimtar

është se ai nuk mbrohet nga një shtet. Ndryshe nga DNP, DNH i jep termit “refugjat” një interpretim të gjerë dhe përfshin në të personat e zhvendosur, të cilët janë shpërngulur nga shtëpitë e tyre për shkak të konfliktit të armatosur ose trazirave të brendshme dhe mbeten brenda kufijve të vendit të tyre.¹⁴⁷

Konfliktet e vazhdueshme në Irak që nga ndërhyrja amerikane më 2003, pastaj luftërat që nga Pranvera Arabe që filloi në dhjetor 2010, sidomos konflikti në Siri që ka hyrë në vitin e shtatë, kanë sjellë një situatë të papritur për vendet e Unionit Evropian, me valë të mëdha dhe të vazhdueshme të refugjatëve që ia mësyjnë shteteve të UE-së.¹⁴⁸ Statistikat e tmerrshme të atyre që humbin jetën gjatë përpjekjeve për të kaluar Mesdheun për të arritur në shtetet e fuqishme të UE-së, shoqëruar me pamje të llahtarshme të publikuara në media sociale dhe konvencionale kanë depërtuar në secilën shtëpi në kontinent, duke ndarë edhe opinionin publik në mbështetës dhe mikpritës të refugjatëve, si dhe të atyre që refugjatët i shohin si kërcënim për vlerat perëndimore dhe mënyrës së tyre të jetesës. Kjo pastaj ka reflektuar edhe në zgjedhjen e përfaqësuesve politik në shtetet anëtare të UE-së, rrjedhimisht edhe në vetë UE-në.

Tradicionalisht për arsye të shumta numri më i madh i refugjatëve gjithherë ka qenë në vendet fqinje të vatrës së krizës, por për arsye të

¹⁴⁷ Pietro Verri, Fjalor i së drejtës ndërkombëtare të konfliktit të armatosur, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Tiranë, 2001, fq 120-121.

¹⁴⁸ Sipas statistikave në fund të vitit 2015 rreth 53% e gjithë refugjatëve në botë janë nga tre shtete: Siria (4.9 milion), Afganistani (2.7 milion) dhe Somalia (1.1 milion). Burimi: <http://www.unhcr.org/statistics/unhcrstats/576408cd7/unhcr-global-trends-2015.html> shikuar më: 05.05.2017.

sipërpërmendura edhe Evropa ka qenë destinacion i tyre, me rreth 6% të refugjatëve në botë të akomoduar në shtetet e Evropës.¹⁴⁹

Andaj menaxhimi i një situatë të tillë të paprecedentë nuk ishte i lehtë për shtetet e Unionit Evropian ku në fillim të vitit 2015 në Evropë ishin 3,075,200 refugjatë, ndërsa në fund të atij viti ky numër arriti në 4,362,600 refugjatë apo rritje me 1,316,200 refugjatë.¹⁵⁰ Kësaj i shtohet fakti që rruga e refugjatëve për në vendet e UE-së kalonte edhe në shtete që nuk ishin anëtare të UE-së, siç është rasti i Turqisë apo i shteteve të Ballkanit Perëndimor. Kështu që u bë domosdoshmëri krijimi i normave ligjore të UE-së, hartimin e fondeve dhe strategjive vepruese, por edhe vetë shtetet anëtare krijuan mekanizmat e ndryshëm ligjor dhe veprues për menaxhimin e situatës.

Korniza ligjore e UE-së për menaxhim të refugjatëve

Në të kaluarën UE nuk ka pasur qasje integruese për politikat e azilit dhe migrimit. Në vitet 80-të kjo çështje erdhi në krye të agjendës së shteteve evropiane. Më 1985 u miratua Konventa Implementuese e Marrëveshjes Shengen, kurse më 1990 Konventa e Dublinit që përcakton shtetin përgjegjës për shqyrtim të kërkesës për azil. Pas Traktatit të Mastrihtit më 1992, çështja e azilit u inkorporua në shtyllën e tretë (Drejtësia dhe Punët e Brendshme).¹⁵¹ Për kohën ky ishte një përparim i madh, përkundër që rrethanat e ndryshuar tani disa dekada më pas treguan domosdoshmërinë e reformimit të tyre. Ndryshime tjera u bënë me Traktatin e Amsterdimit dhe me Traktatin e

¹⁴⁹ <http://www.unhcr.org/figures-at-a-glance.html> shikuar më: 06.05.2017.

¹⁵⁰ UNHCR, Global Trends: Forced Displacement in 2015, fq 14. Burimi: <http://www.unhcr.org/statistics/unhcrstats/576408cd7/unhcr-global-trends-2016.html> shikuar më: 06.05.2017.

¹⁵¹ Vlorë Shemsedini, Refugjatët në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Temë e Masterit, Kolegji Victory, Prishtinë, 2014. fq 33-34.

Lisbonës, mirëpo kriza e madhe e refugjatëve është me e re se miratimi i këtyre traktateve, kështu që duhej përshtatur situatave të reja të paraqitura.

Menaxhimi i valës së refugjatëve, rrjedhimisht azilkërkuesve në Unionin Evropian ka shkuar nëpërmjet Sistemit Evropian të Përbashkët të Azilit dhe agjencia mbështetëse e saj Zyra Evropiane për Mbështetjen e Azilit.

Komisioni Evropian ka paraqitur në maj dhe korrik 2016, draftin për reformimin e këtij sistemi, për shkak të vështirësive të paraqitura në zbatimin e saj nga shtetet e UE-së, si dhe valëve të mëdha të refugjatëve.¹⁵² Refugjati posa të arrijë në UE i merren gjurmët e gishtërinjve. Informacioni shkon në bazën e të dhënave Eurodac ku gjithë shtetet kanë qasje. Pastaj në bazë të këtyre të dhënave aplikohet rregullorja e Dublinit për identifikimin e vendit të përshtatshëm për trajtimin e kërkesës për azil.¹⁵³

Ky reformim i sistemit ishte paraparë edhe në vitin 2015 në Agjendën Evropiane për Migrimin ku parashiheshin masat afatshkurta dhe afatmesme që duhet ndërmarrë UE. Si masa afatshkurta parashihen: aksionet e menjëhershme për të parandaluar humbjen e jetëve të refugjatëve në det, duke rritur fondet për kërkimshpëtim të Frontex, rritjen e rolit të Europol për çmontimin e rrjeteve kriminale në Mesdhe, si dhe procedura të shpejta për të regjistruar refugjatët dhe zhvendosje solidare të tyre. Ndërsa si masa afatmesme parashikohen: zvogëlimi i stimujve të migracionit të parregullt, ruajtja e jetëve dhe kufijve të jashtëm të UE-së, forcimi i politikës së jashtme

¹⁵² https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-migration/background-information/docs/20160713/factsheet_the_common_european_asylum_system_en.pdf shikuar më 16.05.2017.

¹⁵³ Po aty.

të azilit dhe zhvillimi i një politike të re mbi migrimin, duke pasur parasysh trendet demografike me të cilat ballafaqohet Unioni Evropian, duke lehtësuar hyrjen e punëtorëve të kualifikuar për nevojat ekonomike të UE-së.¹⁵⁴

Më herët në vitin 2010, Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan rregulloren për themelimin e Zyrës Evropiane për Mbështetjen e Azilit, për të harmonizuar një procedurë efektive në përputhje me traditën dhe vlerat e Unionit Evropian.¹⁵⁵ Kjo është vazhdimësi e Rregullores së Dublinit të lartpërmendur.

Unioni Evropian mori vendimin e datës 14 dhjetor 2016 mbi mobilizimin e Instrumentit të Fleksibilitetit, për ndarjen e buxhetit për të adresuar valët e refugjatëve dhe sigurinë për vitin 2017 deri në vitin 2020.¹⁵⁶ Instrumenti i Fleksibilitetit i krijuar së pari më 1999, është në vazhden e përpjekjeve për ta bërë më funksional kornizën buxhetore të UE-së.

Bashkëpunimi UE me shtetet tjera për menaxhimin e valës së refugjatëve

¹⁵⁴ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, A European Agenda on Migration, Brussels, 13.05.2015. Burimi: https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-migration/background-information/docs/communication_on_the_european_agenda_on_migration_en.pdf shikuar më 17.05.2017.

¹⁵⁵ Official Journal of the European Union, L 132/11, Regulation (EU) No 439/2010 of the European Parliament and of the Council of 19 May 2010 establishing a European Asylum Support Office. Burimi: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1495225204436&uri=CELEX:32010R0439> shikuar më 10.05.2017.

¹⁵⁶ Official Journal of the European Union, L 50/53, Decision (EU) 2017/342 of the European Parliament and of the Council of 14 December 2016 on the mobilisation of the Flexibility Instrument to finance immediate budgetary measures to address the on-going migration, refugee and security crisis Burimi: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32017D0342&rid=2> shikuar më 13.05.2017.

Menaxhimi i situatave të krizës siç është kjo e refugjatëve është i pamundur për shtetet veçmas, edhe nëse janë të integruara në një organizatë si Unioni Evropian. Bashkëpunimi është esencial për suksesin e projekteve menaxhuese me refugjatët. Koshient për këtë që me paraqitjen e krizës, UE filloi kontaktet dhe përkrahjen me shtetet joanëtare.

Në tetor 2015, Komisioni Evropian ndau 10 milion euro për forcimin e kapaciteteve të shteteve të Ballkanit Perëndimor (Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë) në përgjigjen ndaj rritjes së refugjatëve.¹⁵⁷ Këto shtete kanë qenë korridor transit i refugjatëve për UE dhe gjenden në faza të ndryshme të integritimit në UE, ku disa kanë hapur negociatat për anëtarësim, disa janë shtete kandidate apo aspiruese për atë status, andaj ndihma që UE ndau për këto shtete është tejet e dobishme. Probleme tjera në këtë pjesë lindën kur shtetet tjera të Ballkanit, që janë pjesë e UE-së siç janë Sllovenia dhe Kroacia kishin bllokuar kalimin transit të refugjatëve për në shtetet tjera të UE-së, duke mbyllur një korridor të rëndësishëm të kalimit të refugjatëve.¹⁵⁸ Kjo kishte ndodhur në mars 2016, menjëherë pas marrëveshjes UE-Turqi.

Përpos tyre, që nga viti 2005, Qasja Globale ndaj Migrimit dhe Mobilitetit (The Global Approach to Migration and Mobility - GAMM) është një kornizë gjithëpërfshirëse e politikës së migracionit të jashtëm të UE-së dhe

¹⁵⁷ European Parliament, Directorate-General for external policies, Does the EU have the right instruments to finance assistance in protracted crises and the needs of upper middle income countries?, AFET, 2016. fq 22. Burimi: [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/578027/EXPO_STU\(2016\)578027_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/578027/EXPO_STU(2016)578027_EN.pdf) shikuar më 13.05.2017.

¹⁵⁸ <https://www.theguardian.com/world/2016/mar/09/slovenia-and-croatia-ban-the-transit-of-refugees> shikuar më 22.05.2017.

azilit. Në bazë të kësaj zhvillohet dialog i Unionit Evropian dhe shteteve joanëtare duke u fokusuar në katër objektiva: mirëorganizimi i migrimit të ligjshëm, parandalimi i migracionit të parregullt dhe çrrënjosjen e trafikimit me qenie njerëzore, promovimi i mbrojtjes ndërkombëtare dhe rritjen e dimensionit të jashtëm të azilit. Sikurse politikat tjera, edhe GAMM zbatohet nëpërmjet një sërë instrumentesh ligjore të UE-së (lehtësimi i vizave apo marrëveshjet e riatdhesimit) si dhe programe financiare të UE-së.¹⁵⁹

Njëri prej këtyre programeve që ndihmon zbatimin e GAMM, është Mobility Partnership Facility, ku UE bashkëpunon me këto shtete: Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Kepi i Gjelbërt, Jordani, Maroku, Moldavi, Tunizi, Etiopi, Indi dhe Nigeri, program i cili ka filluar nga janari 2016 dhe parashihet të zgjasë 35 muaj.¹⁶⁰

Që nga viti 2013 UE ka krijuar fondet e saja për menaxhimin e krizave të tilla të refugjatëve të quajtur Fondi i Trustit të UE-së (EU Trust Funds), ku shpejtë lansoi tri programe të tilla:

- Fondi i Trustit Bêkou (Bêkou Trust Fund) i themeluar më 2014 nga Komisioni Evropian dhe Franca me rreth 113 milion euro.
- Fondi i Trustit Regjional për Siri (EU Regional Trust Fund for Syria) i njohur edhe si Fondi Madad, i themeluar në dhjetor 2014 për ndihmë refugjatëve nga Siria në vendet fqinje. Fondi më 11 Shkurt 2016 grumbullonte në total 708.53 milion euro.

¹⁵⁹ https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/international-affairs/global-approach-to-migration_en shikuar më 15.05.2017.

¹⁶⁰ https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/international-affairs/global-approach-to-migration/mobility-partnership-facility_en shikuar më 15.05.2017.

- Fondi i Trustit Emergjent për Afrikë (Emergency Trust Fund for Africa) i lansuar gjatë Samitit Valetta mbi Migrimin të mbajtur në nëntor 2015 dhe fokusohej në katër fusha: a) programe për krijimin e mundësive për punësim, b) aktivitete për riaftësimin duke mbështetur shërbimet bazë për popullatën lokale, c) përmirësimin e menaxhimit të migracionit, d) programe të përgjithshme për përmirësimin e qeverisjes duke parandaluar konfliktin dhe nxitjen e zbatimit të ligjit.¹⁶¹

Fondet e tilla (EUTF) kanë mekanizmat e pavarura menaxhuese, të cilat janë jashtë buxhetit të UE-së, ose EDF-së (European Development Fund është buxhet i financuar drejtpërdrejt nga vendet e UE-së dhe i menaxhuar jashtë kornizës buxhetore të UE-së). Ekziston Bordi i Fondit të Mirëbesimit (Trust Fund Board) udhëhequr nga Komisioni Evropian, Shërbimi i Jashtëm Evropian i Aksionit (EEAS) dhe vëzhguesit. Bordi vendos për strategjinë e fondeve, ndërsa ekzistojnë Komitetet Operacionale, tërë kjo për të mundësuar një vendimmarrje të shpejtë. Fondet EUTF janë krijuar jashtë debatit në Parlamentin Evropian dhe minojnë ndërhyrjet e interesave shtetërore të anëtarëve të UE-së.¹⁶²

Edhe në Agjendën Evropiane për Migrimin parashihej të themelohej në Niger një qendër shumëqëllimore në bashkëpunim me IOM dhe UNHCR.¹⁶³

¹⁶¹ European Parliament, Directorate-General for external policies, Does the EU have the right instruments to finance assistance in protracted crises and the needs of upper middle income countries?, AFET, 2016. fq 25 Burimi: [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/578027/EXPO_STU\(2016\)578027_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/578027/EXPO_STU(2016)578027_EN.pdf) shikuar më 13.05.2017.

¹⁶² Aty, fq 25-26

¹⁶³ Communication from the Commission to the European Parliament, the council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, A European Agenda on Migration, Brussels, 13..05.2015. fq 5. Burimi:

Kjo është në përputhje me fondin e lartpërmendur për Afrikë. Kjo qendër në Niger është munduar të bind banorët atje që nuk ia vlen të udhëtosh në Evropë. Sipas zyrtarëve të UE-së, ky pilotprojekt ka pasur sukses në ndalimin e migrantëve që kalonin përmes Nigerit në Libi që kishte rënë nga 70000 në maj në 1500 në nëntor 2016.¹⁶⁴

Njëra ndër marrëveshjet më të diskutueshme, qoftë për shkak të rëndësisë që zbatimi i saj ka për UE-në, qoftë për shkak të përplasjeve diplomatike mes palëve dhe fuqisë politike të këtyre aktoreve është marrëveshja UE-Turqi e arritur në mars 2016, e cila përbëhej nga këto 9 klauzola, kryesoret nga të cilat ishin: Të gjithë migrantët që kalojnë nga Turqia në Greqi pas 20 marsit 2016, do rikthehen në Turqi, ndërsa për çdo sirian të kthyer në Turqi do jetë UE që do pranoj një sirian tjetër, Turqia do ndërmarrë masat e nevojshme që të ndalojë migrimin e paligjshëm në det nga Turqia për në ishujt grek, UE do i jap ndihmë financiare Turqisë për lehtësimin e menaxhimit të refugjatëve nga ana e shtetit turk, do ndodh vazhdimi i negociatave për anëtarësim dhe liberalizimi i vizave.¹⁶⁵ Një vit pas marrëveshjes, mund të thuhet që ka pasur pika pozitive të zbatimit të saj, por me mosmarrëveshje të shumta mes palëve dhe kërcënime për prishje të marrëveshjes. Madje në atë kohë kishte edhe diskutime mbi përputhjen e kësaj

https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-migration/background-information/docs/communication_on_the_european_agenda_on_migration_en.pdf shikuar më 22.05.2017.

¹⁶⁴ <https://www.newsdeeply.com/refugees/community/2017/01/17/the-e-u-s-hollow-success-over-migrant-smuggling-in-niger> shikuar më 20.05.2017.

¹⁶⁵ European Commission, Fact Sheet, EU-Turkey Statement: Questions and Answers, Brussels, 19.03.2016. Burimi: [europa.eu/rapid/press-release MEMO-16-963_en.pdf](https://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-16-963_en.pdf) shikuar më 19.05.2017.

marrëveshje me të drejtën ndërkombëtare, ku një reagim të tillë pati Komisioneri i Lartë për refugjatët në OKB, Filippo Grandi.¹⁶⁶

Përshtatja e kornizës ligjore të shteteve të veçanta

Sigurisht që bashkëpunimi supranacional në kuadër të UE-së nuk është gjithherë i mjaftueshëm. Shtetet e UE, për shkak të specifikave të ndryshme gjeopolitike dhe gjeoekonomike shpesh përballen me sfida të ndryshme në kuadër të sfidës së madhe për menaxhimin e refugjatëve. Nga kjo ka lind edhe nevoja që shtetet të nxjerrin edhe aktet e tyre ligjore.

Vetë Rregullorja Nr 604/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit thekson që zbatimi i saj efektiv mund të lehtësohet nga bashkëpunimet bilaterale mes departamenteve të shteteve të veçanta (neni 28).¹⁶⁷ Kjo rregullore vendos kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e shtetit anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare të përcaktuar nga një person në ndonjë vendet e UE-së.

Gjermania e udhëhequr nga kancelarja Merkel ka promovuar një politikë mikpritëse për refugjatët, duke përshtatur edhe legjislacionin vendas. Në vitin e kaluar (2016) rreth 60.5% e tërë aplikimeve për azil në vendet e UE-së dhe CEFTA-s kanë qenë në Gjermani me rreth 612.500 aplikues, ku rreth 70% e vendimeve kanë qenë pozitive.¹⁶⁸ Shteti tjetër i madh në UE, Franca ka

¹⁶⁶ <https://www.theguardian.com/world/2016/mar/08/un-refugee-agency-criticises-quick-fix-eu-turkey-deal> shikuar më 19.05.2017.

¹⁶⁷ Official Journal of the European Union, Regulation (EU) No 604/2013 of the European Parliament and of the Council of 26 June 2013 establishing the criteria and mechanisms for determining the Member State responsible for examining an application for international protection lodged in one of the Member States by a third-country national or a stateless person (recast). Burimi: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2013:180:0031:0059:EN:PDF> shikuar më 13.05.2017.

¹⁶⁸ http://www.migrationpolicy.org/programs/moving-europe-beyond-crisis?gclid=CjwKEAjwr_rIBRDJzq-Z-

vetëm 32.2% aprovime ndaj kërkesave për azil nga ana e refugjatëve, nga 6.1.% e totalit të azilkërkuesve që i janë drejtuar këtij shteti. Presidenti i sapozgjedhur francez, Macron ka paralajmëruar që do rrisë bashkëpunimin me Gjermaninë dhe me shtetet tjera për menaxhimin e valës së refugjatëve.

Në Gjermani, Akti i Vendbanimit (The Residence Act) rregullon hyrjen, qëndrimin, punësimin dhe ndërprerjen e vendbanimit të të huajve. Ajo shërben për të kontrolluar dhe kufizuar fluksin e të huajve (jo shtetas të UE-së) në Gjermani.¹⁶⁹ Bundestagu gjerman më 2016 miratoi një ligj që ndan 7 miliardë euro për integrim të refugjatëve. Një ligj tjetër me vlerë 500 milion euro është rezervuar për ndërtimin e banesave sociale më 2017 dhe 2018. Qeveria ka premtuar 100.000 vende të reja pune për të sapoardhurit.¹⁷⁰ Tani kur jemi një vit pas, rishtazi Bundestagu ka miratuar një ligj mjaftë të debatueshëm mbi "për zbatimin më rigoroz të detyrimit për largim nga Gjermania". Kundërshtarët e ligjit theksuan që "ky ligj e kthen Gjermaninë nga një vend i pranimit në një vend të dëbimit", por ministri i brendshëm gjerman mbrojti ligjin duke theksuar që kjo ndalon abuzimin e refugjatëve me të mirat dhe solidaritetin gjerman.¹⁷¹

Në anën tjetër kemi shtete sikurse Hungaria, ku qeveria e udhëhequr nga Orbán ka shtrënguar legjislacionin e saj për refugjatët azilkërkues, duke

[LC_2HgSJADoL57HSLHBqxtXvU0XC2SNGp2lBcCalzc_3JVqYP20LJR8aBoCyWLw_wcB](#) shikuar më 22.05.2017.

¹⁶⁹ http://www.bmi.bund.de/EN/Topics/Migration-Integration/Law-Foreigners/law-foreigners_node.html;jsessionid=82AEE57A390AE6C141A51AFB7C5EA5BE.2_cid364 shikuar më 25.05.2017.

¹⁷⁰ <https://www.theatlantic.com/international/archive/2016/09/merkel-isis-refugee-germany-afd/499550/> shikuar më 11.05.2017.

¹⁷¹ http://www.dw.com/sq/bundestagu-vendos-ashp%C3%ABrsimin-e-ligjit-t%C3%AB-azilit-a-38908255?maca=alb-TB_alb_gazetaexpress-22181-html-cb shikuar më 21.05.2017.

ndaluar azilkërkuesit që arrijnë në Hungari dhe duke i kthyer prapa në Serbi. Ky veprim së fundi është kritikuar edhe nga ana e Parlamentit Evropian duke i bërë thirrje Këshillit Evropian që ta aktivizojë artikullin 7 të Traktatit të UE-së, që i bën thirrje një vendi anëtar si paralajmërim formal për shkelje të drejtave të njeriut që mund të pasoj me suspendim të votës.¹⁷² Hungaria vitin e kaluar ka aprovuar vetëm 12.6% të aplikuesve për azil, duke lënë prapa vetëm Poloninë me 11.7%.¹⁷³ Edhe vendimet kroate dhe sllovene mbi bllokimin e kalimit transit të refugjatëve, që janë përmendur paraprakisht në punim, kanë sjellë vështirësi për menaxhimin me refugjatë të shteteve tjera të Ballkanit.

Problemet me sigurimin e kufijve të jashtëm të UE-së kanë sjellë situatën kur shumë shtete kanë rikthyer kontrollimet në kufijtë e brendshëm mes tyre, duke rrezikuar seriozisht edhe funksionimin e shengenzonës, duke e bazuar këtë në Kodet e Shengenzone, përkatësisht nenet 23, 24 dhe 25 të cilat parashikojnë shtimin e kontrolleve të shteteve anëtare për periudha të caktuara. Si rezultat i zgjatjeve të shpeshta të këtyre kontrolleve kufitare, Këshilli Evropian ka lëshuar një rekomandim për shtetet që të kenë parasysh rrezikimin që po i bëjnë tërë zonës Shengen me këto kontrolle, duke bërë thirrje për liberalizimin e tyre.¹⁷⁴

¹⁷² <http://www.reuters.com/article/us-eu-hungary-idUSKCN18D1LX> shikuar më 18.05.2017.

¹⁷³ http://www.migrationpolicy.org/programs/moving-europe-beyond-crisis?gclid=CjwKEAjr_rIBRDJzq-Z-LC_2HgSJADoL57HSLHBqxtXvU0XC2SNGp2lBcCalzc_3JVqYP20LJR8aBoCyWLw_wcB shikuar më 22.05.2017.

¹⁷⁴ Council of the European Union, Interinstitutional File: 2017/0014 (NLE), Brussels, 7.02.2017. Burimi: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-6020-2017-INIT/en/pdf> shikuar më 11.05.2017.

Pikërisht këto mosmarrëveshje mes vendimeve të shteteve anëtare dhe politikës së UE-së për azilin, sollën nevojën e reformimit të Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit për të proceduar më shpejtë kërkesat në presionin e lartë të refugjatëve dhe për të minimizuar efektin e vendimeve kundërthënëse.

Konkluzione dhe rekomandime

Nga rritja enorme e ardhjes së refugjatëve në kufijtë e UE-së, janë ndërmarrë një sërë masash ligjore, financiare dhe programore për menaxhimin e situatës. Rezultate janë arritur për ta mbajtur situatën të kontrolluar, megjithatë gjendja mbetet mjaftë e brishtë. Sigurisht që UE-në dhe shtetet në veçanti i presin sfida edhe në të ardhmen.

Shengenzona ka qenë dhe mbetet mjaftë e rrezikuar. Shtetet duhet t'i rishikojnë kontrollimet kufitare që aplikojnë, pavarësisht të drejtës legale për ta bërë atë. Sigurimi i kufijve të jashtëm të UE-së, ndikon në uljen e nevojës për kontrollore të kufijve kombëtar të shteteve anëtare.

Instrumentet e shumta që ka themeluar UE për menaxhimin e krizës së refugjatëve duhet të koordinohen me instrumentet ekzistuese afatgjate për të pasur një perspektive më largpamëse për menaxhimin e situatave të ndryshme që mund të paraqiten. Gjithashtu integrimi i refugjatëve në shoqëritë perëndimore duhet të jetë në fokus të vazhdueshëm të qeverive lokale dhe qendrore të vendeve të UE-së.

Duhet bërë forcimin dhe propagandimin e idesë dhe vlerave evropiane në mënyrë që lëvizjeve populiste antirefugjate në Evropë të u zvogëlohet mundësia për ndikim. Humbja e kandidatëve populist në zgjedhjet në Austri, Holandë dhe Francë i kanë dhënë një frymëmarrje forcave prointegruese,

megjithatë rreziku mbetet me disa qeveri nacionaliste në pushtet në disa shtete dhe me disa qeveri tjera që gjenden në presion nga lëvizje anti-UE, anti-refugjatë dhe me nuanca pro-Ruse.

Forcimi i marrëdhënieve me shtetet fqinje të UE-së në kuadër të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, qoftë të atyre që janë aspirantë për anëtarësim (shtetet e Ballkanit Perëndimor), qoftë të rajoneve tjera në kuadër të Partneritetit Lindor apo të Unionit për Mesdheun është i interesit jetik. UE vazhdon të mbetet një gjigant ekonomik dhe programet financiare mbështetëse për shtetet jashtë kufijve politik janë shumë të rëndësishme, pasi që në epokën e globalizmit, trazirat në shtetet e tjera, kanë ndikim të madh dhe përcaktojnë edhe agjendën e vet Unionit Evropian, gjë e cila u dëshmuar me trazirat e Pranverës Arabe dhe valën e refugjatëve në vitet e fundit. Marrëveshja UE-Turqi është njëra prej zotimeve për ndihmë financiare të UE-së për një shtet joanëtar, por shumë determinues edhe për vetë ekonominë dhe sigurinë e Unionit Evropian. Andaj përkundër sfidave që janë paraqitur, është në të mirën e UE-së që të bëhet trysni për zbatimin e plotë të saj.

Koordinimi i bashkëpunimit me organizatat tjera relevante si UNHCR, IOM dhe organizata tjera humanitare dhe joqeveritare që në domenin e tyre kanë punën me refugjatët dhe ndajnë të njëjtat vlera me shtetet e Unionit Evropian mund të sjellë rezultate të lakmueshme imediate.

Bibliografia

Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, A European Agenda on Migration, Brussels, 13..05.2015. Burimi:

[https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-migration/background-](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-migration/background-information/docs/communication_on_the_european_agenda_on_migration_en.pdf)

[information/docs/communication_on_the_european_agenda_on_migration_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-migration/background-information/docs/communication_on_the_european_agenda_on_migration_en.pdf) shikuar më 17.05.2017 dhe 22.05.2017.

Council of the European Union, Interinstitutional File: 2017/0014 (NLE), Brussels, 7.02.2017. Burimi:

<http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-6020-2017-INIT/en/pdf> shikuar më 11.05.2017.

European Commision, Fact Sheet, EU-Turkey Statement: Questions and Answers, Bussels, 19.03.2016.

Burimi: [europa.eu/rapid/press-release MEMO-16-963_en.pdf](http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-16-963_en.pdf) shikuar më 19.05.2017.

European Parliament, Directorate-General for external policies, Does the EU have the right instruments to finance assistance in protracted crises and the needs of upper middle income countries?, AFET, 2016.

fq 22. Burimi:

[http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/578027/EXPO_STU\(2016\)578027_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/578027/EXPO_STU(2016)578027_EN.pdf) shikuar më 13.05.2017.

[http://www.bmi.bund.de/EN/Topics/Migration-Integration/Law-Foreigners/law-](http://www.bmi.bund.de/EN/Topics/Migration-Integration/Law-Foreigners/law-foreigners_node.html;jsessionid=82AEE57A390AE6C141A51AFB7C5EA5BE.2_cid364)

[foreigners_node.html;jsessionid=82AEE57A390AE6C141A51AFB7C5EA5BE.2_cid364](http://www.bmi.bund.de/EN/Topics/Migration-Integration/Law-Foreigners/law-foreigners_node.html;jsessionid=82AEE57A390AE6C141A51AFB7C5EA5BE.2_cid364) shikuar më 25.05.2017.

http://www.dw.com/sq/bundestagu-vendos-ashp%C3%ABrsimin-e-ligjit-t%C3%AB-azilit-a-38908255?maca=alb-TB_alb_gazetaexpress-22181-html-cb shikuar më 21.05.2017.

[http://www.migrationpolicy.org/programs/moving-europe-beyond-crisis?gclid=CjwKEAjwr_rIBRDJzq-Z-](http://www.migrationpolicy.org/programs/moving-europe-beyond-crisis?gclid=CjwKEAjwr_rIBRDJzq-Z-LC_2HgSJADoL57HSLHBqxtXvU0XC2SNgP2lBcCalzc_3JVqYP20LJR8aBoCyWLw_wcB)

[LC_2HgSJADoL57HSLHBqxtXvU0XC2SNgP2lBcCalzc_3JVqYP20LJR8aBoCyWLw_wcB](http://www.migrationpolicy.org/programs/moving-europe-beyond-crisis?gclid=CjwKEAjwr_rIBRDJzq-Z-LC_2HgSJADoL57HSLHBqxtXvU0XC2SNgP2lBcCalzc_3JVqYP20LJR8aBoCyWLw_wcB) shikuar më 22.05.2017.

<http://www.reuters.com/article/us-eu-hungary-idUSKCN18D1LX> shikuar më 18.05.2017.

<http://www.unhcr.org/figures-at-a-glance.html> shikuar më: 06.05.2017.

<http://www.unhcr.org/statistics/unhcrstats/576408cd7/unhcr-global-trends-2015.html> shikuar më:
05.05.2017.

https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-migration/background-information/docs/20160713/factsheet_the_common_european_asylum_system_en.pdf shikuar më
16.05.2017.

https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/international-affairs/global-approach-to-migration_en shikuar më 15.05.2017.

https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/international-affairs/global-approach-to-migration/mobility-partnership-facility_en shikuar më 15.05.2017.

<https://www.newsdeeply.com/refugees/community/2017/01/17/the-e-u-s-hollow-success-over-migrant-smuggling-in-niger> shikuar më 20.05.2017.

<https://www.theatlantic.com/international/archive/2016/09/merkel-isis-refugee-germany-afd/499550/>
shikuar më 11.05.2017.

<https://www.theguardian.com/world/2016/mar/08/un-refugee-agency-criticises-quick-fix-eu-turkey-deal> shikuar më 19.05.2017.

<https://www.theguardian.com/world/2016/mar/09/slovenia-and-croatia-ban-the-transit-of-refugees>
shikuar më 22.05.2017.

Official Journal of the European Union, L 132/11, Regulation (EU) No 439/2010 of the European Parliament and of the Council of 19 May 2010 establishing a European Asylum Support Office. Burimi:
<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1495225204436&uri=CELEX:32010R0439>
shikuar më 10.05.2017.

Official Journal of the European Union, L 50/53, Decision (EU) 2017/342 of the European Parliament and of the Council of 14 December 2016 on the mobilisation of the Flexibility Instrument to finance immediate budgetary measures to address the on-going migration, refugee and security crisis Burimi:

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32017D0342&rid=2> shikuar më 13.05.2017.

Official Journal of the European Union, Regulation (EU) No 604/2013 of the European Parliament and of the Council of 26 June 2013 establishing the criteria and mechanisms for determining the Member State responsible for examining an application for international protection lodged in one of the Member States by a third-country national or a stateless person (recast). Burimi: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2013:180:0031:0059:EN:PDF> shikuar më 13.05.2017.

Pietro Verri, Fjalor i së drejtës ndërkombëtare të konfliktit të armatosur, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Tiranë, 2001.

UNHCR, Global Trends: Forced Displacement in 2015, fq 14. Burimi: <http://www.unhcr.org/statistics/unhcrstats/576408cd7/unhcr-global-trends-2016.html> shikuar më: 06.05.2017.

Vlora Shemsedini, Refugjatët në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Temë e Masterit, Kolegji Victory, Prushtinë, 2014.

PhD. Cand. Hysni Skura, KU Bedër
Dashuria Hyjnore në këndvështrimin Islam

"Me të vërtetë Zoti është Mëshirëplotë dhe gjithë dashuri." ¹⁷⁵

Abstrakt

Në një botë ku teknologjia e ka tejkaluar edhe kohën, ngrihet një problem akoma edhe më i madh, boshllëku shpirtëror që ajo krijon. Një boshllëk që sado i vogël qoftë ai nuk mund ta mbushnin as "shpikjet" apo arritjet më të fundit, sepse teknologjia nuk e ka dhe nuk ka për ta gjetur formulën e lumturisë, për të mbushur këtë zbrazëti.

Dashuria për Zotin është shkaku i ekzistencës së gjithësisë, është drita dhe jeta e universit. Dashuria, siç thotë një mendimtar i njohur, është ndjenja e parë që e zgjon njeriun, djepi i parë ku ai përkundet. "Në zemrën e njeriut është përqendruar një dashuri që përfshin gjithë ekzistencën." Dhe padyshim që "botën e ndritur e të lumtur të së ardhmes mund ta ndërtojnë vetëm ata heronj të dashurisë, që veprojnë në emër të saj."

Keywords: Dashuri, ekzistencë, Zot, teknologji, gjithësi

¹⁷⁵ Kuran, Surja Hud, 90.

I. Konceptet lidhur me temën

Dashuria është ndjenjë e fuqishme shpirtërore njerëzore universale; ndjenjë e fortë, e thellë, bazë e harmonisë sociale dhe e ujdisë me vetveten. Dashuria është baza e miqësisë midis njerëzve, e cila e ka burimin në Unitetin e krijimit dhe Njeshmërinë e Krijuesit. Ajo është prirje e brendshme drejt diçkaje që na tërheq. Dashuria Hyjnore përfaqëson dëshirën dhe përkujdesjen e pakufishme të Krijuesit për krijesat e veta. Shkalla më e lartë, kulmi i dashurisë njerëzore është adhurimi vetëm për Krijuesin e Gjithësisë. *“Dashuria është eliksiri që e kthen gurin në flori, dëlirëson shpirtin dhe i fal njeriut forcë, guxim e krenari, është uji i jetës të cilin njeriu e kërkon me aq etje.”*¹⁷⁶

Dhembshuria gjithashtu është një ndjenjë njerëzore, një nga llojet e dashurisë e përtej saj, e cila qëndron midis dashurisë dhe mëshirës. Ajo është ndjenja që ushqen e manifeston dikush për njerëzit që i do a që i dhimbsen, duke ndjerë thellësisht keqardhje dhe shpirtbutësi deri në prirjen për t’iu ardhur në ndihmë menjëherë e me gjithçka atyre. Dhembshuria është shpirtbutësi, dashamirësi, shpirtmadhësi e gatishmëri për ndihmë e sakrificë për njeriun në të keq e në nevojë. Njeriu i dhembshur përkëdhel me dhembshuri, flet dhembshurisht, ndihmon e jep, me aq sa mundet, shpirtbardhësisht.

Mëshira është një ndjenjë e thellë dhe e fuqishme dhembshurie, keqardhjeje, ngushëllimi, faljeje e shpëtimi për krijesat dhe njerëzit e mjerë, ndërthurur me dëshirën e madhe për t’i ndihmuar ata, për t’i shpëtuar nga e

¹⁷⁶ Ali Ynal

keqja ku kanë rënë dhe që i ka zënë. Është dëshira e madhe dhe prirja e natyrshme, e cila, bazuar në dashurinë, mirësinë, dhembshurinë, zemërgjerësinë e butësinë shpirtërore, kërkon t’ua falë apo t’ua zbutë fajin e gabimin të tjerëve. E kundërta e mëshirës është rreptësia, ashpërsia, egërsia, keqbërja, keqdashja, mizoria, dënimi, braktisja, shkretimi, gjakataria, ndëshkimi, shkatërrimi.

Shkalla më e lartë e mëshirës është Mëshira Hyjnore, Mëshira e Zotit. Ajo është mëshira absolute. Mëshira është dritë e Zotit. Është cilësi hyjnore vetëm e Krijuesit, thelbi i Tij. Mëshira e vërtetë buron prej së larti. Mëshira është fryma, rruga, shpirti që bashkon Zotin me njeriun, si krijesë e krijuar posaçërisht për këtë tokë, për këtë dhé, me një qëllim të caktuar. Kjo mëshirë e spastron njeriun. Mëshirë e madhe e bekim i Krijuesit për botën është ardhja e Profetëve dhe kumtimi i Librave të Shenjtë.

II. Shenja dalluese të dashurisë së Zotit për njeriun

a. Krijimi i njeriut si mëkëmbës në tokë

Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë”¹⁷⁷

Domethënia e caktimit të njeriut si mëkëmbës është që ai të jetë i obliguar për ndërtimin e tokës dhe për të ngritur shoqërinë njerëzore në mënyrë

¹⁷⁷ Kuran, Surja Bekare, 30.

që përputhet me ligjin dhe drejtësinë e Zotit dhe sipas planit që Ai e ka hartuar për njeriun.

b. Krijimi i njeriut në formë të përsosur.

Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer”¹⁷⁸

Mjafton që njeriu të shikojë mirësitë dhe begatitë që e rrethojnë, për të kuptuar se sa shumë Zoti e do atë. Gjithçka që na rrethon shpreh dashuri, është dashuri. Vallë a e kuptojmë ne se dielli ndërsa lind e perëndon, yjet ndërsa vezullojnë, petalet e lules teksa shtrijnë krahët, cicërimat e zogjve, era që lehtas fytyrën përkëdhel, përçojnë mesazhin e një dashurie të pafund?! Dhe kjo dashuri vjen vetëm si rezultat i dashurisë që Krijuesi ka për njeriun.

c. Vlerësimi i njeriut mbi krijesat e tjera

Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit¹⁷⁹

Çdo dashuri në këtë botë është e destinuar që të vdesë. Vetëm ajo (dashuria për Zotin) nuk vdes kurrë, ajo është e përjetshme. Një dashuri e tillë nuk është e pamundur, ajo kërkohet dhe gjendet, duke medituar, duke reflektuar e duke lexuar Librin e Gjithësisë, e më pas duke hapur zemrën që ajo të hyjë, siç thotë mendimtari i njohur Fethullah Gylen “dashuria rritet dhe zhvillohet në gjirin e diturisë. Ata të cilët nuk janë të ditur nuk mund të dashurojnë gjithçka...” Sa më shumë ta njohim Zotin aq më shumë do të kuptojmë dashurinë e Tij ndaj nesh. Sepse njeriu sa më shumë të njohë dikë aq

¹⁷⁸ Kuran, Surja Tin, 4.

¹⁷⁹ Kuran, Surja Isra, 70.

më shumë do ta dojë, dhe rezultat i kësaj dashurie është dashuria sublime dhe absolute që burimin e ka tek Zoti

Argumentet e shumta që na rrethojnë do të na çojnë në portën e saj, por brenda nuk mund të të fusin. Të lumtur do të jenë ata që do ta gjejnë e do ta mbajnë fort pas vetes, që do ta bëjnë pjesë të jetës së tyre, në çdo frymëmarrje, e për ta në mes të shkretëtirës do të valëviten flamujt e shpëtimit, sepse “zemrat që nuk njohin dashurinë, nuk mund të shpëtojnë dot nga labirintet e vërteta të egos... *Jetojnë e vdesin pa e kuptuar atë dashuri pafund që ka në themel ekzistenca.*”. Ne duhet ta kërkojmë këtë dashuri, dashurinë sublime, pavarësisht se në ç’rrugë të vështira do të na duhet të kalojmë, “mjafton që kjo rrugë të mbarojë në pikën e fundit të përkryerës njerëzore”

d. Optimizmi dhe Mëshira e Zotit ndaj Krijesave

Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.”¹⁸⁰

Dyert e dashurisë janë të mbyllura ndaj çdo pesimizmi dhe harmoninë e saj nuk e prish asgjë, zemrat me dashuri kurrë nuk do të vyshken por do të lulëzojnë nën dritën e saj. “Kudo ku është dëgjuar zëri i dashurisë, i butë dhe i ëmbël si një ninullë, të gjithë zërat e tjerë, të gjithë instrumentet kanë heshtur dhe të gjithë të bashkuar kanë soditur në qetësi melodinë e saj.”

¹⁸⁰ Kuran, Surja Zumer, 53.

Ndër emrat më të bukur, më madhështorë dhe më të dashur të Krijuesit, të cilat përmenden në krye të këndimit të çdo kapitulli Kuranor janë “I Gjithëmëshirshmi”, “Mëshirëploti”. Sa besim, shpresë, gëzim dhe lumturi ngjallin në shpirtin e njeriut këta emra të shenjtë, të pashoq, shumë të dashur e më të bukurit në gjithësi! Edhe nëse do të jetonin qindra e mijëra vjet, shpirtrat pa dashuri nuk do të mund të ngriheshin kurrë në horizontin e përsosjes njerëzore. Drejt të përsosurës dhe së përkryerës shkohet duke sakrifikuar veten për të tjerët, duke dashur për fqinjin atë që do për veten, duke dhënë jetën për hir të fëmijës tënd, duke ia kushtuar jetën lumturisë për të tjerët, duke jetuar e duke vdekur për gjithë njerëzimin. “Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”.¹⁸¹

Një histori...

Në kohën e profetit Muhamed (paqja qoftë mbi Të), pas një beteje një nënë po kërkonte foshnjën e saj që i kishte humbur. Çdo fëmijë që shihte e merrte e përqaftonte, e nuhaste dhe pasi e kuptonte që nuk është i saj e linte sërish dhe vazhdonte kërkimin. Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi Të) sëbashku me shokët e Tij po e ndiqnin me lot në sy të gjithë skenën. Më në fund nëna e gjen foshnjën dhe e shtrëngon në kraharor plot dhembshuri. Në ato momente Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi Të) ju drejtohet shokëve të Tij duke thënë: a mendoni se kjo nënë do ta hidhte foshnjën e saj në zjarr pas këtij momenti? Dhe ata i përgjigjën: Jo o profet i Zotit. Dhe Ai shton: Zoti është më i mëshirshëm më robërit e Tij sesa kjo nënë me foshnjën e saj.

¹⁸¹ Kuran, Surja Ali Imran, 31.

“Ata që arrijnë këtë dashuri sublimë, janë të mëdhenj në vogëlsinë e tyre, të fuqishëm në pafuqinë e tyre, mjaft të pasur në varfërinë e tyre, për të merituar mbarë universin.”

Dashuria për Krijuesin është elementi më thelbësor për çdo qenie, është ndriçimi më rrezatues dhe forca më e madhe, e aftë të rezistojë dhe të kapërcejë gjithçka tjetër. Dashuria për Të lartëson çdo shpirt që e rrëmben atë dhe i përgatit këta shpirtra për udhëtimin në amshim. Shpirtrat që kanë qenë të aftë të kenë lidhje me përjetësinë, vënë në përdorim vetveten për të frymëzuar të gjithë shpirtrat e tjerë me çfarë kanë përfutur ata vetë prej amshimit.

Dashuria për Zotin është thelbi i gjithçkaje dhe burimi më i kulluar dhe i pastër për të gjitha dashuritë. Mëshira dhe dashuria vërshojnë në zemrat tona prej Tij. Çdo lloj i bashkëpunimit njerëzor do të ndërtohet në përputhje me marrëdhëniet tona me Atë. Dashuria për Zotin është besimi ynë, bindja jonë. Ai na bëri të gjallë kur ne u krijuam. Nëse ne jetojmë sot, është vetëm nëpërmjet Tij. Esenca e gjithë ekzistencës është dashuria e Tij dhe fundi është shtrirja e dashurisë hyjnore në formën e parajsës. Ai ka krijuar çdo gjë të kushtëzuar në dashuri dhe ka lidhur marrëdhëniet e Tij me njerëzimin nga kënaqësia e shenjtë për qeniet e dashura.

Përsa u përket besimtarëve, ata e duan Zotin para çdo gjëje tjetër, dhe ndjejnë dhembshuri për të tjerët përmes dashurisë për Atë. Për arsye të manifestimit dhe bekimit nga Një i Vetmi, ata mbajnë lidhje me çdo njeri dhe gjithçka tjetër, deklarojnë dashurinë e tyre dhe janë mirënjohës për gjithë të mirat në emër të Tij.

Sigurisht, pa marrë Zotin në konsideratë, çdo dashuri për këtë ose atë objekt është e kotë, e pashpresë, e pavendosur dhe e pafrytshme. Mbi gjithçka, një besimtar duhet të dashurojë Atë, dhe ka një qëndrim pozitiv ndaj të tjerëve vetëm sepse ata janë manifestime dhe pasqyrime plot ngjyra të Atributeve dhe Emrave Hyjnorë të Tij. Po ashtu, njeriu duhet t'i mirëpresë këto gjëra me një admirim të madh dhe çdo herë që një person vështron gjëra të tilla, duhet të mendojë se edhe ato janë prej Zotit, duke përjetuar, kështu, një periudhë tjetër bashkimi me të Dashurin. Vërtet, për ata që mund të analizojnë, çdo krijesë është një pasqyrë e shkëlqyer dhe një mburrje e shkruar në varg të madh, mbi gjithçka tjetër është pamja njerëzore, pasqyrim i sekretit të Mëshiruesit.

O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty!¹⁸²

e. Kur Zoti e do një njeri!

Thotë profeti Muhamed (paqja e Zotit qoftë mbi të): “Kur Zoti e do një njeri, thërret Xhibrilin (Gabrielin) dhe i thotë: “O Xhibril (Gabriel), unë e dua filanin, prandaj duaje dhe ti!” dhe e do edhe Xhibrili (Gabrieli), i cili nga ana e tij, thërret: “O banorë të qiellit (engjëj)! Zoti e do filanin, prandaj duajeni dhe ju!” dhe e duan edhe banorët e qiellit. Mandej, dashuria për këtë njeri, instalohet dhe tek zemrat e banorëve të tokës.”

Shohim se sa konkrete është dashuria e Zotit për njeriun? Shohim se Zoti e deklaroi këtë dashuri para krijesave më të fisme e më të pastërta? Sigurisht që do të ishte e mjaftueshme që Zoti ta donte njeriun, por jo, Ai nuk

¹⁸² Kuran, Surja Fexhr, 27-28.

mjaftohet me kaq, Ai ia deklaroi këtë fakt Xhibrilit (Gabrielit) dhe engjëjve të tjerë. Ngaqë Zoti e do, tashmë e do dhe Xhibrili (Gabrieli) bashkë me engjëjt e tjerë, e për rrjedhojë, fillojnë dhe e duan dhe banorët e tokës.

Në një hadith Kudsij¹⁸³ Zoti thotë: “Robi Im nuk afrohet tek unë me ndonjë vepër më të dashur sesa obligimet (farzet) me të cilat e kam ngarkuar. E kur robi im vazhdon të afrohet më shumë ndaj Meje me adhurime suplementare, atëherë filloj ta dua, e nëse e dua, do të jem syri me të cilin shikon, veshi me të cilin dëgjon, dora e tij me të cilën prek, këmba me të cilën ec. Nëse do të më kërkojë diçka, do ia jap dhe nëse do të kërkojë mbrojtjen Time, do ta ketë.”

Një lutje

O Zot, o ti më i Lavdëruari! Sot kur urrejtja dhe smira kanë errësuar gjithçka, ne gjejmë shpëtim në dashurinë Tënde të pafund dhe lutemi në derën Tënde së pari që Ti të mbushësh zemrat e mëkatarëve, robërve të Tu të pamëshirshëm, me dashuri dhe ndjenja njerëzore!

O Zot, prej Teje kërkojmë mbarësinë, të mirën e kësaj dite dhe të ditëve të tjera dhe prej Teje kërkojmë mbrojtjen nga e liga e kësaj dite dhe ditëve të tjera. O Zot, kërkojmë mbrojtjen Tënde nga përtacia dhe mendjemadhësia. O Zot, na mbro nga dënimi në botën tjetër.

Zoti ynë, na i mbulo të metat e tona dhe na qetëso në momentet trishtuese.

¹⁸³ Hadith kudsij do të thotë fjalë e cila transmetohet direkt nga Zoti tek ne, nëpërmjet gjuhës së Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi Të)

O Zoti im, Ti je Ai i Cili i di të fshehtat dhe të dukshmet, Krijues i qiejve dhe i tokës, Zot i çdo sendi dhe Mbizotërues i saj; kërkojmë mbrojtjen Tënde nga e keqja e vetes tonë dhe nga e keqja e djallit.

Ne emër te Allahut, kërkoj mbrojtje me fuqinë dhe madhështinë e Tij nga e keqja që me mundon dhe te cilës i frikësohem.

O Zot, na mundëso që të të falënderojmë për të mirat Tua që na i dhurove ne, familjeve tona, prindërve tanë. Zoti ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë

Zoti ynë, laji zemrat tona me ujin e borës dhe breshërit, pastroji zemrat tona prej mëkateve ashtu sikur pastrohet rroba e bardhë prej papastërtisë dhe na largo prej mëkateve ashtu sikurse ke larguar Lindjen prej Perëndimit. Zoti ynë, kërkojmë strehim tek Ti nga përtacia, mëkati dhe borxhi.

O Zoti ynë, kërkojmë që të na mbrosh nga ndërprerja e dhuntisë Tënde, nga largimi i faljes Tënde, nga ardhja e papritur e dënimit Tënd dhe hidhërimit Tënd në çdo gjë.